

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 DHJETOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

SI DO TË VOTOJË
DIASPORA SHQIPTARE ?



PETRIT KUÇANA

Kaq pak dihet për mënyrën
sesi do të votojë diaspora,
saqë duket sikur zgjedhjen
do të zhvillohen pas ca
vitesh e jo pas ca muajsh.
(vijon faqe 2)



ARBEN MANAJ

ANGLI, 20 MIJË
TË ARDHUR ME
GOMONE,
SHKAK LA MANSHI
"I QETË"


SHQIPTARËT NDËRTOJNË
MAQEDONINË
QË NUK I DO ATA
SI MURATORË TË SAJ!

KIM MEHMETI



NISMA PËR RISHIKIMIN
E PËRDORIMIT ZYRTAR
TË GJUHËS SHQIPE – PROJEKT
DESTABILIZUES

EMIN AZEMI



E PAT THËNË AT ZEF PLLUMI:
'RRNO PËR ME TREGUE',
PO ÇFARË TË RRËFESH
MË PARË

SONILA MEÇO



ME SY, VESH
E MENDJE
NGA VENECIA

LUTFI DERVISHI



SPINOZA NË
ZUBIN-POTOK

VETON SURROI



POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: 020 7018 7929

Dotech
website




The Albanian newspaper in London


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Qaq pak dihet për mënyrën sesi do të votojë diaspora, saqë duket sikur zgjedhjen do të zhvillohen pas ca vitesh e jo pas ca muajsh. E gjitha që dihet, silltet rrëth faktit se shqiptarët e diasporës, do të kenë të drejtë të votojnë për herë të parë në këto zgjedhje, dhe se Edi Rama, ka bërë ca ture në disa vende, ku u ka kërkuar votën

SI DO TË VOTOJË DIASPORA SHQIPTARE ?



shqiptarëve të diasporës për mandatin e katërt.

Çuditërisht asnjë fushatë ndërgjegjësimi për tu regjistruar nuk është parë e arsyeshme të ndërmerret nga institucionet shqiptare dhe se, diku nga janari, mësohet se do të fillojë ai që quhet regjistrimi diasporës.

Shifrat e deritanishme të shqiptarëve të regjistruar që jetojnë jashtë, janë disa mijëra, shumë më pak se numri i shqiptarë që jetojnë në veri të Londrës.

Nëse do të shikojmë fushatat e vazhdueshme të Kosovës për regjistrimin e Diasporës (duhet theksuar se shqiptarët e Kosovës e kanë të drejtën e votimit nga jashtë) duket se institucionet

shqiptare në rastin më të mirë, janë shumë mbrapa, për të mos shkuar tek aludimet se punët e tyre do i kryejë partia në pushtet. Nuk janë të pakta rastet kur janë publikuar formularët me listat që u kërkojnë administratës publike për të plotësuar me të afërmit që

jetojnë jashtë.

Ky duhet se mbetet hapi i parë drejt prishjes së një procesi zgjedhor, ku mundësia e kontrollit të votës së diasporës mbetet edhe më e vogël. Kurrësesi nuk dëshirohet të besohet se insitimi i kryeministrit për salla të mbushura

me njerëz në diasporë, me çdo kusht e çdo çmim, (sa kanë kush-tuar fjalimet e Ramës?) mund të jetë në funksion të propagandës së diaspora e do kryeministrin.

Pse duhej vonuar ka shumë për regjistrimi e diasporës?

Pse nuk u mor modeli i Kosovës? Përse nuk ka filluar fushata sensibilizuese për regjistrimin dhe votimin e diasporës?

Përse duhet pritur janari për të marrë vesh se si do të regjistrohet e si do të votojë diaspora?

A mund të ishte bërë kjo më së miri nga institucionet e shtetit shqiptar, qysh në momentin që u miratua në parlament?

Këto pyetje duket se do të marrin përgjigje vonë shumë vonë.

VOTA E DIASPORËS/ SHQIPTARËT QË JETOJNË JASHTË KËRKOJNË GARANCI PËR INTEGRITETIN E PROCESIT ZGJEDHOR

Shumica e shqiptarëve mbështesin të drejtën e votës për diasporën, por bashkatdhetarët që jetojnë jashtë vendit kanë pak informacion mbi procesin dhe mund të mos jenë të gatshëm të paguajnë kostot për dërgimin e fletëvotimit me postë.

Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2024, për herë të parë, diaspora shqiptare do të ketë mundësinë të votojë, një hap që pritet të transformojë skenën politike të vendit. Me mbi një milion shqiptarë që jetojnë jashtë, përfshirja e tyre zgjedhore mund të ndryshojë ndjeshëm ekuilibrat elektoralë dhe të shënojë një kapitull të ri për demokracinë shqiptare.

Megjithatë, ndërsa procesi zgjedhor përparon, një anketë e realizuar nga Faktaje.al ka zbuluar se 71% e emigrantëve të anketuar deklarojnë se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për procesin e votimit, ndërsa një pjesë kërkojnë garanci për integritetin e procesit zgjedhor.

“Kam dëshirë të votoj në zgjedhje, por jam e shqetësuar që vota mund të vidhet apo tjetërsohet,” shkruan Silvana, një shqiptare që jeton në Gjermani.

Ndërsa Shqipëria përballlet me këtë eksperiment historik, sfida mbeten të shumta. Si do të sigurohet qartësia dhe besueshmëria e procesit? Dhe, më e rëndësishmja, a do të jetë diaspora shqiptare e gatshme të shfrytëzojë këtë mundësi për të bërë zërin e saj të dëgjohet?

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, ka shpjeguar se për të marrë pjesë në votim, emigrantët shqip-

tarë duhet fillimisht të regjistrohen përmes një aplikacioni të posaçëm të KQZ-së, i cili do të jetë funksional në janar 2025.

“Aplikacioni shërben vetëm për regjistrimin si votues nga jashtë dhe për përfshirjen në listën e votuesve nga jashtë,” tha Celibashi. Ai sqaroi se “procesi i votimit do të kryhet përmes postës, ku KQZ-ja do të dërgojë fletën e votimit në adresën e deklaruar nga votuesi.”

Pra, nuk do të ketë votim përmes aplikacionit. Roli i tij është thjesht për të përgatitur listën e votuesve nga jashtë, theksoi Celibashi.

Kosto e votës Kodi Zgjedhor përcakton që procedura e votimit nga shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja. Votimi për zgjedhësit jashtë vendit nis me dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm nga KQZ-ja në adresën e deklaruar të zgjedhësit dhe përfundon njëkohësisht me mbylljen e qendrave të votimit në Shqipëri.

Materialet zgjedhore, që përfshijnë një fletë votimi me element të veçantë dal-lues, dërgohen me postë. Zgjedhësit duhet t'i kthejnë këto fletë të plotësuar dhe të sekretuara në adresën zyrtare të KQZ-së, duke mbuluar vetë shpenzimet postare.

Megjithatë, shumë zgjedhës nuk janë dakord me këtë praktikë. Sipas anketës

të Faktaje.al, 92% e të anketuarve shprehen kundër mbartjes së kostos së postës nga vetë zgjedhësit.

“Kostot e pagesës duhet të mbulojnë nga KQZ për dërgimin dhe kthimin e fletës së votimit. Gjithashtu, duhet të ketë monitorim nga organizata të pavarura të diasporës,” tha Agimi, një emigrant në Zvicër.

Rigels Xhemollari, drejtues i organizatës “Qëndresa Qytetare,” e sheh këtë praktikë si një pengesë për të drejtat zgjedhore.

“Pagesa e postës përbën një barrierë për ushtrimin e të drejtës së votës, duke i vënë asaj një lloj çmimi. Kjo mund të hapë edhe hapësira për tentativa manipulimi, prandaj shteti duhet të mbulojë këto kosto, përfshirë kthimin e votës në Shqipëri,” argumentoi ai.

Xhemollari shtoi se ky vendim duhet të merret përpara publikimit të listës së votuesve të regjistruar, për të shmangur debatet mbi përdorimin e burimeve publike pas identifikimit të votuesve potencialë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, theksoi se qeveria po shqyrton mundësinë e mbulimit të këtyre kostove.

“Kemi pasur diskutime me përfaqësues të qeverisë, madje edhe në nivelet më të larta, dhe kemi arritur në përfundimin se, të paktën për këto zgjedhje të para të votimit nga jashtë, shteti shqiptar duhet të

paguajë kostot e kthimit të fletës së votimit nga votuesi të KQZ-ja,” deklaroi ai.

“Kam besim që kështu do të ndodhë,” përfundoi Celibashi.

Ndikimi i votës së diasporës Sipas listës së votuesve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rreth 3.65 milionë shtetas shqiptarë në moshë madhore kanë të drejtë vote. Bazuar në të dhënat e Censit 2023, statisticienët vlerësojnë se rreth 1.7 milionë prej këtyre zgjedhësve jetojnë jashtë vendit, në diasporë. Një shumicë dërrmuese e shqiptarëve mbështesin të drejtën e votës për bashkatdhetarët me banim jashtë vendit. Sipas anketës, 85% e pjesëmarrësve u shprehën dakord që diaspora të përfshihet në procesin zgjedhor. Megjithatë, disa shfaqin shqetësime për angazhimin e qytetarëve të diasporës ndaj sfidave të përditshme me të cilat përballen shqiptarët që jetojnë në vend.

“Është e vërtetë që shqiptarët e diasporës janë qytetarë shqiptarë, por mendoj se fuqia e votës së tyre duhet të jetë në përpjesëtim me aktivizimin e tyre në shoqërinë shqiptare,” tha Fationi, një votues me banim në Shqipëri, duke sugjeruar që diaspora të ndikojë vetëm në zgjedhjen e 20 deputetëve.

“Nuk mund të vlejë një lloj si vota ime, që jetoj, punoj dhe paguaj taksa, si vota e një personi që Shqipërinë e ka si rrob

e ‘fast fashion’,” shtoi ai.

Sipas draftit të KQZ-së, qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe duan të votojnë, duhet të paraqesin një kërkesë individuale për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit brenda një afati që fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 68 ditë përpara kësaj date.

Rigels Xhemollari, drejtues i organizatës “Qëndresa Qytetare,” sugjeron që KQZ-ja të veprojë me shpejtësi, ndërsa aktorët politikë të tregojnë gatishmëri për të ndryshuar rregullat që lehtësojnë procesin e votimit. Ai thekson nevojën për të prodhuar fletë të votimit më herët dhe për t'i dërguar emigrantëve të paktën tre javë përpara zgjedhjeve.

“Në të kundërt, shumë vota mund të mos arrijnë në Tiranë deri më 11 maj, në orën 19:00,” paralajmëroi Xhemollari.

Ai nënvizoi gjithashtu se administrimi dhe numërimi i votave të diasporës është më i sigurt se ai i votave brenda vendit.

“Për herë të parë në Shqipëri, kjo votë do të administrohet dhe numërohet nga një administratë e depolitizuar, pasi në proces do të përfshihen nëpunës të KQZ-së, jo komisionerë të dërguar nga partitë politike,” përfundoi ai. Nga Ilda Hoxha / Faktaje.al /

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore,
ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë
çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel: 0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



ARBEN MANAJ

Justifikimi me detin e qetë në ujërat e ngushticës mes Francës dhe Anglisë, për shtimin e numrit të të ardhurve me gomone drejt brigjeve angleze, është një muzikë e njohur e luajtur edhe nga konservatorët e qendrës së djathtë tashmë në opozitë në Britani.

Ky avaz, duket se hedh poshtë dhe zhbën, financimet deri në afro një miliardë sterlina që Londra i jep Parisit për të frenuar kalimet ilegale dhe të rrezikshme

në ngushticën rreth 35 km në Kanalin angleze apo La Mansh sipas francezeve.

Që nga ardhja e laburistëve në pushtet, shifra e kalimeve e ka kaluar tashmë 20 mijë vetëve, dhe asnjëri prej tyre nuk është quajtur pushtues, si dikur shqiptarët përpara dy vjetësh, në numra më të larte sesa aktualisht nëpër këto gomone. Sipas qeverisë aktuale periudha 31 ditore mes tetorit dhe nëntorit ka pasur numrin më të lartë të ditëve të qeta në lundrim të njohura si "red days", kur kushtet atmosferike e bëjnë më të mundshme ose shumë të mundshme kalimin e ngushticës me gomone.

Për të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar, nga 768 vetë të mbërritur, këtë vit shifra ishte në 6288 vete, rreth dhjetë herë më



shumë.

Ndërkohe 122 vetë kanë mbërritur gjatë fundjavës. Këto shifra dalin në kohën kur Ministria e Brendshme britanike do njoftojë një marrëveshje të arritur me qeverinë e Irakut për

bashkëpunimin në luftën kundër grupeve të trafikantëve dhe shtimin e rikthimeve të të mbërriturve drejt Irakut.

Ndërkohe luftimet në Siri nuk përbëjnë lajm të mirë edhe pse

ato po ndodhin kur dimri sapo ka trokitur. Laburistët dukshëm, ashtu si edhe konservatorët nuk po kanë një plan dhe afate të qarta se kur do mund dhe si do mund jo vetëm të frenojnë, por edhe rikthejnë të ardhurit, të cilët me shumë gjasa do vazhdojnë të qëndrojnë në ishull, pasi nuk prahen nga shumica e vendeve nga vijën dhe nuk kanë të ndalur.

Madje laburistët nuk është se po lenë të nënkuptohet se do ketë ndonjë amnisti të mundshme në të ardhmen.

Në kushte të tilla kalimet po vazhdojnë dhe laburistët janë në po të njëjtin hall si edhe konservatorët, totalisht të pafuqishëm për të ndryshuar situatën.

Dotech
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

MY **UK**
Law ✓

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA

MY **UK**
Visas ✓

Ne jemi të specializuar në:
Çështje emigracioni
Çështje familjare dhe divorci
Pronësi
Neglizhencë
Gjopa dhe dënime rrugore



Arta Heath

Avokate dhe Partnere Menaxhuese

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30



Huddersfield

Besmir Mujo

+44 (0) 7861 391147



Sheffield

Klodiana Gjonaj

+44 (0) 7454 819683



London

Daniel Buna

+44 (0) 7832 599757



Tirana

Dorotea Celaj

+355 69 659 8957

Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 20:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



reviewsolicitors
TRUSTED LAW FIRM



"EXCELLENT"

4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS



Ranked
TOP 10%

2024



Solicitors
Regulation
Authority



ARBEN MANAJ


Kozma Papa, 22-vjeçari që jetonte jashtë Londrës, e ka kryer vrasjen e bashkatdhetarit të tij Bledi Petraj, 37 vjeç në 4 shkurt të këtij viti në zonën e Southgate-it në verilindje të Londrës pasi të dy, si vrasësi dhe viktima njiheshin me njëri-tjetrin dhe kishin pasur një përplasje fizike më herët në një kafene.

Por në procesin gjyqësor u mësua se 45 minuta më vonë të dy kishin shkuar në një zonë

tjetër të Londrës, ku secili mbante thika të mëdha me vete.

Të dy, sipas prokurorit të çështjes, i drejtonin njëri-tjetrit, derisa viktima Bledi Petraj, humbi kontrollin e thikës dhe vrasësi, Kozma Papa e kapi thikën dhe me dy thika në duar, në kohën pasi viktima kishte rënë në tokë e ka goditur 13 herë në mënyrë të vazhdueshme viktimën, i cili edhe pse u gjet i gjallë nga ambulanca nuk arriti t'i shpëtojë dot dhe ndërroi jetë pas disa orësh në spital në pasditen e 4 shkurtit të këtij viti.

Për këtë krim Kozma Papa është dënuar me burgim të përjetshëm. Por Gjykata Qendrore në



Londër kërkoj për Papën që të vuaj minimalisht 20 vjet heqje lirie.

Autori i vrasjes u kap nga Poli-

cia duke u larguar me makinë jashtë Londrës dhe e pranoi vrasjen e kryer.

Janë disa dhjetëra raste vrasjesh

VRAU BASHKATDHEHETARIN E TIJ NË LONDËR, SHQIPTARI 22-VJEÇAR DËNOHET ME BURGIM TË PËRJETSHËM

shqiptarësh ndër vite në Britani, për arsye që lidhen nga pazaret e prishura të drogës e deri për motive të dobëta. Por hetuesit e Policisë Metropolitane në këtë rast nuk specifikojnë shkakun dhe motivin e vërtetë që çoi në përplasjen fizike që rezultojë me humbjen e jetës së 37-vjeçarit Bledi Petraj me banim në Londër.

Kryededepektivi britanik Mathew Goode, thotë: "I shprehim ngushëllimet familjes së Bledit dhe të dashurve të tij që mbajnë zi për vdekjen e tij. Kishim të bënim me një përleshje fizike që përfundojë në një humbje të pakuptimtë të jetës dhe Papa do vuaj një kohë jashtëzakonisht të gjatë me të drejt, prapa hekurave".

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website 

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



The Albanian 

Emigracion dhe Prona

- Aplikacione per visa bashkshortore, si te fejuar dhe visa turistike
- Heqja e Nenshtetsis Britanike
- Ankesat gjyqsore, Ndalimi pa letra ne Kampe Emigracioni dhe Urdhra Deportimi
- Aplikime per Viza Studenti dhe Viza Pune
- Aplikime per Viza ne Baza te Drejtave te Njeriut nga brenda Britanis
- Ceshtje Azii dhe Skllaveri Moderne

- Shitje dhe Blerje te Pronave
- Rihipoteka dhe Financimi i Pronave
- Dhenie me Qira te pronave Komercale
- Zgjatje dhe Rinovime te Kontratave te Pronave Komercale

Sigurojeni te ardhmen tuaj sot me keshillen e duhur profesionale ligjore!



Po Kerkoni Per Ndhime Juridike Nga Ekspert Legal?

Per me shume informacion:

Kontaktoni Partner dhe Avokate:

Oliverta Mediu

Phone: 020 7063 9040

Mobile: 079 4603 5736

Email: o.mediu@wslegal.co.uk

Address: 2nd Floor 2-5 Minories,
EC3N 1BJ

SONILA MEÇO

Si ka mundësi të vijojë po e njëjta filozofi e fshehjes së krimit, manipulimit, fajësimit të viktimës e mos ndryshojë asgjë veç moshës së të pafajshmit që le këtë botë më të ndyrë se para tij?

Klodian Rasha, 25 vjeç

Policia do të bënte këto deklarata:

“Me datë 08.12.2020, rreth orës 01:45, shërbimet e Policisë gjatë patrullimit në rrugën “Dritan Hoxha”, kanë konstatuar një shtetas i cili kryente veprime të dyshimta. Punonjësit e Policisë i kanë bërë thirrje të ndalonte por personi nuk i është bindur urdhrat të Policisë për të ndaluar. Edhe pas thirrjeve të vazhdueshme të bëra nga ana e Punonjësit të Policisë për të ndaluar përsëri nuk ka ndaluar dhe është larguar me vrap duke i drejtuar punonjësit të policisë një send të fortë në dukje armë zjarri. I gjendur në këto kushte dhe në mungesë të ndriçimit të plotë punonjësi i policisë ka qëlluar me armë zjarri dhe për pasojë ka mbetur i plagosur shtetasi K.R., 25 vjeç i cili ka humbur jetën në spital.”

Në vijim të veprimeve hetimore të kryera nga Grupi i Posaçëm Hetimor i përbërë nga SHÇBA dhe Policia nën drejtimin e Prokurorit gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe zonës përreth u bë e mundur gjetja e armës së zjarrit që dyshohet se i përkiste shtetasit K.R., i cili nuk iu bind urdhrat të Punonjësit të Policisë për të ndaluar.”

Pra Klodianit iu “mboll” arma në duar, polici e organe ligjzbatuese e vranë për së dyti, duke manipuluar prova. E vërteta?

Ish polici qëllon për vdekje me plumb pas shpine të riun ne orët e para të 8 dhjetorit 2020

E PAT THËNË AT ZEF PLLUMI: ‘RRNO PËR ME TREGUE’, PO ÇFARË TË RRËFESH MË PARË



ne rrugicën e shtëpisë së 25vjeçarit në Laprakë.

Eglantin Proga, 42 vjeç

Më 10 gusht 2024, Policia njoftoi se Egli Proga në gjendje të dehur është rrëzuar në rrugë dhe ka vdekur.

Më 11 gusht, Policia thotë se vdekja nuk ishte aksidentale por se ishte ‘vrasje me dashje’.

Më 12 gusht, familjarët akuzojnë se ngjarja po fshihet nga policia. Drejtori i Policisë Muhamet Rrumbullaku mohon akuzat.

14 gusht, “Vrasje me dashje”, apo vrasje nga pakujdesia? Policia, Prokuroria e Gjykata

kalojnë përgjegjësitë në fushën e njëra tjetrës. Pra Eglantin Proga në Pogradec “vritet” tri herë, nga autori, Policia dhe Prokuroria! □ Policia e Shtetit nuk dha njoftim paraprak zyrtar për ngjarjen ditën kur ndodhi krimi, por vetëm 15 orë pas ngjarjes, sekuestrimi i kamerave u la për në fund, dëshmitarët okularë dhanë dëshmi kontradiktore për ngjarjen dhe u hoqën prova nga vendngjarja. □ Prokuroria pa patur pamjet filmike e prova e cilësoi si “vrasje nga pakujdesia”. □ Prokuroria e Korçës ia hodhi fajin policisë se përse është zbutur akuza ndaj autorit të ar-

restuar Denis Meçe dhe nënvizon se kualifikimi i veprës penale në “vrasje nga pakujdesia” ishte bërë pikërisht në bazë të materialeve që vetë policia kishte dërguar në prokurori. Duke lënë të kuptohet se materialet që ishin referuar nuk provonin se kishim të bënim me një vrasje me dashje.

Në media u përhap dosja paraprake e prokurorisë e mbushur me dëshmi të personave që fshehën krimin.

Martin Cani, 14 vjeç

Qysh nga 18 nëntori i kobshëm, veç kontradikta e paradokse gjithnjë e më ulëritëse shoqërojnë zbardhjen e së vërtetës.

Policia pretendoi se kish gjetur armën e krimit, një thikë, që nuk ngjan me atë që poston autori. Policia përgënjeshtroi prindin e një 14 - vjeçari të plagosur, duke theksuar se ka patur vetëm një agresor. Megjithëse në mes të ditës, në rrugë të frekuentuara, plot kamera sigurie, ngjitur me prokurorinë.

Autori i vrasjes nuk çohet në Kavajë, spitali refuzonte të jepte epikrizën. Sot, 8 ditë më pas deklarohet se ka një agresor të dytë, 15 vjeçar, me prindër në institucionet e drejtësisë.

Ndryshojnë veç moshat. Ndërsa monstroziteti i krimit, lidhjet e larta të autorëve, manipulimet, fshehjet dhe mungesa e empatisë, dinjitetit, moralit e profesionalizmit të organeve ligjzbatuese deri në bashkëfajësi me dorën vrastare janë e pandryshueshmja makabre e një palo jete, që po “gëzojnë” shqiptarët.

ALFRED LELA

Tri rezoluta në harkun e 30 ditëve janë një triumvirat trimufi për Partinë Demokratike dhe tri krisma të thata në trekëmbëshin e qeverisë së Edi Ramës.

E thënë kështu duket si teprim, por në u duket i tillë ka të bëjë vetëm me faktin se PD i kanë munguar prej kohe lajmet e mirë që vinin nga të dërguarit apo kancelaritë e Perëndimit.

Rezolutat e iratura nga EPP-Partia Popullore Europiane, CDI-Partitë e qendrës Demokratike dhe IDU- Unioni Demokratik Ndërkombëtar, janë secila në vetvete dhe të tria bashkë, një rezolucion i lartë, jo vetëm mbi çështjet dhe betejat që ka ngritur opozita gjatë tre viteve të fundit, por edhe mbi krizat thelbësore të Shqipërisë.

Drejtimi i rezolutave është në kah krejt kundërt me retorikën zyrtare që Edi Rama mbron dhe përpunon, si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë. Përnjëmend ato thonë çka trumbeton prej kohësh PD, por ato, as mund të vlerësohen, as mund të zhvlerësohen ngase i thotë Partia Demokratike.

Sigurisht, ato janë qëndrime politike të PD, por bëhen qëndrime edhe të këtyre tri organizatave të mëdha politike botërore, në rastin kur miratohen prej tyre. Ne mund vetëm ta imagjinojmë reagimin e Ramës ndaj këtyre prozhektorëve ndërkombëtarë mbi shtetin e

RAMA DHE TRI REZOLUTAT



ngritur prej tij dhe Rilindjes por, po ta bazojmë te reagimi i tij ndaj njëres prej rezolutave, të PPE, e gjejmë përhafshinë e tij. Kryeministri i dërgoi një letër shefit të PPE, Weber (I dashur Manfred!) ku i kërkonte që PPE të mos vazhdojnë me projekt-rezolutën, pra të mos e miratojnë. Si ngahera, Rama nuk e shihhte problemin te vetja dhe qeverisja e tij, por te paradigma e vjetëruar dhe foshnjërake ‘fajin e ka Saliu’. Se çfarë bëri zoti Weber në

reagim ndaj lutje-kërcënimit të Ramës, ju e dini tashmë. Jo vetëm EPP e kaluan Rezolutën, por partitë e djathta dhe të qendrës miratuan unanimisht edhe dy të tjera, edhe më të ashpra. Të dyja këto kërkonin atë që opozita prej kohësh sheh si zgjidhje të krizës politiko-shoqërore-elektorale, një qeveri ndërmjetëse.

Rezolutat kanë në thelb alarmin e rrëshqitjes së shtetit të drejtuar nga Rama, njëfarë anti-

shteti të ndërtuar mbi katër kolona fundosëse të cilat janë lidhjet e krimit me qeverinë/politikën/policinë; zgjedhjet fasadë; gjyqësori/institucionet e kapura, si dhe përndjekja politike e opozitës.

Kjo është pamja me rezolucion të lartë e gjendjes në Shqipëri, ky është thelbi i tekstit të tri rezolutave ndërkombëtare të partive të qendrës dhe të së djathtës, që qeverisin gjysmën e botës, nga Italia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Tani qeverisë i mbetet të pozicionohet përballë këtyre rezultuave, jo si Rilindje klanesh e tarafesh, por si Parti Socialiste e Shqipërisë. Kursi i përhershëm i Ramës e ka se kush kritikon atë dhe qeverinë ka sharë flamurin dhe Shqipërinë. Kjo nuk prodhon zgjidhje, por më shumë struc, që fsheh kokën dhe lë jashtë prapancën.

Një kryeministër dhe qeveri që kaq shpesh i nisin fjalitë me “jam krenar” për këtë e atë (fjala kre-krye është rrënja e krenarisë), nuk bën ta mbyllin me ‘përfundam si b***arë’.

QUALITY

BUDGET FRIENDLY CLINIC

HEALTHCARE

- Same day Appointment
- Well-Being + Gender Scans (16 Week)
- Weight Loss Injections
- Hearth Check-Up
- Health Check-Up
- Botox & Filler & Skin Booster & PRP
- Hair - Loss Mesotherapy Injection

Need a trusted North London GP? Medplus Clinic offers private, convenient healthcare that fits your busy life.

Book appointment via phone or online, choose your time, and enjoy same-day appointments at our easily accessible location near Silver Street Station, Angel Corner-Edmonton. Quality care, in and out in under 30 minutes. Visit Medplus Clinic today!



Medical Services

- GP Consultation
- Paediatric Consultation
- Cardiology Consultation
- Dermatology Consultation
- Gynaecology and Obstetrics Consultation with Ultrasound
- Psychiatry
- Check-Up
- Ear, Nose, Throat (ENT) Consultation
- Ultrasound Scan
- Counselling & Psychotherapy
- Skin Examination
- Injection (without medication)
- Ear Wax Removal
- Psychology



Aesthetic Services

- Migraine Botox
- Masseter Botox
- Underarm (Armpit) Botox
- Filler for Cheeks
- Filler for Nasolabial Folds
- Filler for Marionette Lines
- Chin Filler
- Lip Filler
- Jawline Contouring with Filler
- Non-Surgical Rhinoplasty
- PRP (Platelet-Rich Plasma) Therapy
- Skin Rejuvenation
- Mesotherapy
- Skin Boosters
- Dermapen
- IV Vitamin Drip
- Glutathione Treatment
- IM Vitamin Injections
- Fat-Dissolving Injections
- Hair-Loss Mesotherapy Injections



CHOOSE US FOR :

- ✓ Specialized Expertise
- ✓ Diagnostic Services
- ✓ Vaccinations
- ✓ Holistic Care
- ✓ Check Up



MORE INFORMATION

☎ 02082927485

☎ 07440014118

🌐 www.medplus.org.uk

📍 175 Fore Street
Edmonton London
N18 2XB

Monday - Saturday 9 AM - 6 PM

10% OFF

Stay Connected, Save More with Medplus Clinic! Get £20 OFF just for following us on Facebook or Instagram, and enjoy 10% OFF all treatments at Medplus Clinic.

Follow us for exclusive savings on quality care in North London. Book now!

Follow Us: medplusclinic medplusclinic



MedPlus Clinic



MONITOR

Ftohja e marrëdhënieve politike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës po përcillet edhe në ekonomi me tregtinë në vendnumëro dhe rënien e vizitorëve.

Sipas projeksioneve, PBB-ja e Rajonit pritet të arrijë në 135.3 miliardë euro më 2024, teksa ekonomitë tona, të dyja së bashku, pritet të arrijnë një vlerë prej 33 miliardë eurosh, shumë kjo sa 24% e PBB-së së pritshme të Rajonit.

Ekonomia e Serbisë zë 45% të PBB-së së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria dhe Kosova nuk po i shfrytëzojnë potencialet për bashkëpunim, në mënyrë që të bëhen konkurrese dhe të rrisin mirëqenien e qytetarëve të tyre.

Kosova dhe Shqipëria, dy shtete të të njëjtit komb, nuk i kanë shfrytëzuar potencialet e burimeve natyrore dhe popullsinë e re në moshë për të rritur përfitimet ekonomike.

Në vend që të rritet, popullata shqiptare në rajon është reduktuar dhe është plakur teksa në aspektin ekonomik, konvergjenca me Rajonin ka mbetur e pandryshuar gjatë 10 viteve të fundit. Qeveritë e dy vendeve, me politikat e tyre, nxitën emigrim masiv të popullatës, duke dështuar të krijojnë mundësi sidomos për të rinjtë.

Ekonomitë e dy shteteve bazohen në një model që nuk gjeneron punësim me vlerë të lartë dhe nuk kanë mundur të integrohen në zinxhirët e industrisë si Serbia dhe Maqedonia e Veriut.

Prodhimi i Brendshëm Bruto në vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi ishte rreth 80,5 miliardë euro në vitin 2013, sipas të dhënave nga institucionet financiare ndërkombëtare FMN dhe BB.

Shqipëria dhe Kosova së bashku e kishin PBB-në 19,2 miliardë euro në vitin 2013, vlerë kjo sa 23.8% e PBB-së së Rajonit. Sipas projeksioneve, PBB-ja e Rajonit pritet të arrijë në 135.3 miliardë euro më 2024, teksa ekonomitë tona të dyja së bashku pritet të arrijnë një vlerë prej 33 miliardë eurosh, shumë kjo sa 24% e PBB-së së pritshme të Rajonit.

Përgjithësisht, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë shënuar rënie të popullsisë që kur u shemb regjimi komunist në vitin 1990. Gjatë dekadës

së fundit, popullata shqiptare e dy shteteve ka pësuar rënie të fortë për shkak të uljes së lindjeve dhe emigracionit të lartë, por këto fenomene kanë qenë më të dukshme në Shqipëri dhe në Kosovë, duke bërë që popullsia e dy vendeve të pësojë rënie me 15% dhe 12% secila ndërmjet 2011 dhe 2024.

Shqipëria dhe Kosova gjithashtu janë të integruara më pak në zinxhirin e vlerës së tregut global, duke qenë se sektori i bujqësisë dominon dy ekonomitë dhe sektorët e industrisë ku ofrohen paga më të larta janë më pak të pranishme se në rajon.

PBB, gara Shqipëria-Kosovë

Kosova përjetoi në 1998 një nga luftërat më të përgjakshme në Europë pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Shqipëria doli shumë e varfër nga rrëzimi i një prej regjimeve diktatoriale më të egra. Falimenti i firmave piramidale në vitin 1997 e vështirësoi edhe më tej situatën, pasi një shumicë e madhe familjesh humbën të gjithë kursimet e jetës në këto skema.

Me liberalizimin e tregtisë, të ardhurat nga emigracioni dhe zhvillimi i industrive që kërkonin krah pune, PBB-ja e Shqipërisë shënoi në vitin 2023 mbi 2,3 trilionë lekë (22 miliardë euro). Ky rezultat është 70% më i lartë se në vitin 2013, kur PBB-ja e vendit ishte 1,3 trilionë lekë.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2023 arriti një vlerë të PBB-së 9,76 miliardë euro, me rritje 91% në krahasim me vitin 2013, kur përlloragitej 5 miliardë euro.

PBB e përbashkët Shqipëri – Kosovë zë 33% të ekonomisë së rajonit. Serbia në vitin 2024 pritet të ketë një PBB prej 62 miliardë eurosh, që përbën 45% të PBB-së totale të Rajonit.

Struktura e ekonomisë në vendet e Ballkanit Perëndimor dominohet nga në tre sektorë kryesorë, bujqësia, industria dhe shërbimet. Këta sektorë kanë ndryshuar gjatë viteve, pasi shumica e një pjese të vendeve kanë kaluar nga ekonomitë bujqësore në ekonomi më të orientuara nga shërbimet dhe industrisë.

Vetëm në Shqipëri, struktura e ekonomisë dominohet nga bujqësia, e cila në vitin 2022 zuri 18% të PBB-së. Në Kosovë, bujqësia zë 7% të PBB-së, ndërsa në dy vende të tjera, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, bujqësia zë më pak se 7% të PBB-së dhe në Bosnjë është më pak se 5%.

Në vendet e BE-së, bujqësia zuri më pak se 2.5% të PBB-së më 2022. Zhvillimet e sektorit të bujqësisë janë paradoksale për Shqipërinë, pasi është

SHQIPËRI-KOSOVË, AKULLI QË NUK PO SHKRIN



sektori më i madh në ekonomi, teksa nevojat e konsumit të vendit plotësohen nga importet. Importet bujqësore janë tre herë më të larta se eksportet dhe janë zgjeruar më tej këtë vit.

Ekonomia e Shqipërisë dhe Kosovës ka varësi të lartë nga ndërtimi, i cili nuk sjell produktivitet në afat të gjatë.

Gjatë vitit të kaluar, ndërtimi zuri rreth 11% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, duke e renditur Shqipërinë në vendin e parë në rajon për rëndësinë që ka në ekonomi. Sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT pas Shqipërisë vjen Kosova, ku ndërtimi zë rreth 10% të PBB-së, ndërsa në vendet e tjera, sektori zë 5-7% të PBB.

Ekonomia e Bosnjës ka ekspozimin më të ulët ndaj ndërtimit, me vetëm 5,7% të PBB-së, në Maqedoninë e Veriut ndërtimi zë 5.9% të ekonomisë, në Serbi 7% dhe në Kosovë, pak më shumë se 10%.

Në Serbi dhe Bosnjë, industria është dega kryesore e ekonomisë që kontribuon më shumë se 23% në PBB-në e vendeve. Në Maqedoninë e Veriut, industria zë 19% të PBB-së, ndërsa në Shqipëri, më pak 14%.

Edhe pse me peshë më të ulët, industria në Shqipëri është më pak produktive pasi mbështetet në njësi prodhimi të industrisë fasone të tekstil-këpucës, që punojnë me material porositësi, ndërsa në rajon, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Bosnjë, dega e industrisë është e lidhur me zinxhirin e industrisë automative, e cila ka norma më të larta fitimi dhe prodhon paga më të larta për punonjësit.

Normat e larta të emigrimit të të rinjve po e bëjnë vendin jo tërheqës për transferimin e njësisive të prodhimit. Gjithsesi, me dimensionet e reja të gjeopolitikës globale, ku zinxhirët e prodhimit po transferohen sipas aleancave të reja globale, Shqipëria ka shanse të larta për të tërhequr in-

vestitorë me potencial.

Me gjithë zhvillimet e pritshme, sektori i ndërtimit do të vijojë të ketë kontribut në rritje në ekonominë e Shqipërisë dhe Kosovës.

Ekspertët e ekonomisë në të dy shtetet mendojnë se qeveritë nuk u kanë kushtuar vëmendje zhvillimeve ekonomike.

Kosova është vendi me popullsinë më të re në Europë, ka pasuri nëntokësore, tokë pjellore dhe kapacitete për të rritur prodhimin e energjisë së pastër, por në krahun tjetër, mungojnë politikat dhe mbështetja e duhur politike dhe financiare për t'i zhvilluar më tej këto mundësi.

Gjatë viteve të fundit, zhvillimet politike në vend kanë lënë në hije aspektin ekonomik, tha Mustafë Kadriaj, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës.

Ndërsa eksperti i njohur, Selami Xhepa, thotë se qeveria shqiptare ka zhvilluar një model ekonomik bazuar në vlerën e ulët të punës, teksa përfitimet ekonomike nuk janë ndarë në mënyrë të drejtë përdërisa Shqipëria ende ka 43% të popullsisë në rrezik të varfërisë.

NË “LUFTË” TË FTOHTË

Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës kanë lënë pas edhe bashkëpunimin formal. Nga viti 2008 deri më 2023, qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës kanë zhvilluar 15 mbledhje të përbashkëta, me qëllim thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërmarrjen e reformave të përbashkëta. Mbledhja e fundit u bë në korrik të vitit 2023 në Shkodër dhe deri më tani, kur po mbyllet 2024, nuk është zhvilluar mbledhje tjetër.

Zhvillimet në mbledhjen e fundit kishin të bënin me projektet e për-

bashkëta infrastrukturore, si rrugët dhe hekurudhat, për të lidhur më mirë dy vendet dhe për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave, si dhe zhvillimin e turizmit dhe krijimin e mundësive për të promovuar më shumë bashkëpunimin në këtë sektor.

Kryeministrat Rama dhe Kurti, jo vetëm që nuk po bashkëpunojnë, por shpesh shfaqin si konfliktualë, duke shmangur takimet dhe duke replikuar në distancë.

Kjo marrëdhënie e ftohtë mes qeverisë ka injektuar një frymë në popullsinë e përgjithshme, kur gjithnjë e më shumë shqiptarët e Kosovës nuk preferojnë të pushojnë në Shqipëri. Numri i vizitorëve nga Kosova ra këtë vit, ndërsa volumi tregtar mbeti i njëjtë.

Profesori Safet Gërzhalliu, i cili më parë ka drejtuar Odën Ekonomike të Kosovës, është shprehur se, ekonomistët dhe ekspertët e dy anëve të kufirit duhet të hidhen në veprim. Nuk ka më kohë për të humbur, pasi politika ka dështuar të bashkojë ekonominë.

“Të mos merremi me arsyet pse ky bashkëpunim mungon, por të ulemi të gjejmë zgjidhjet, – propozon ai. Grupet e ekspertëve duhet të ulen dhe të hartojnë një program të përbashkët, ku në themel të jetë harmonizimi i taksave dhe tatimeve, njësimi i programeve arsimore, politikat e zhvillimit në shërbim të tregut të përbashkët dhe më pas qeveritë në të dy anët ta kenë në krye të axhendës”, thotë ai.

Shqipëria ka nënshkruar me Kosovën marrëveshje bashkëpunimi më shumë se me çdo vend tjetër, por në realitet, një seri konfliktesh tregtare numërohen që kur Kosova shpalli pavarësinë, të cilat shpesh morën parametrat e një lufte tregtare. Shembulli tipik është viti 2013, kur një seri konfliktesh tregtare në të cilat u përfshinë edhe

qeveritë ndikuan për keq tregtinë ndërmjet shteteve.

Blokimi i qumështit shqiptar në tregjet e Kosovës u pasua me bllokimin nga pala shqiptare të importit të mishit dhe të miellit nga Kosova. Konflikti me miellin u përsërit gjatë vitit 2016-2017. Në 10-vjeçarën e fundit, barra tarifore në tregtinë mes dy vendeve u rrit me tarifa e taksa indirekte.

Kosova vuri në vitin 2014 një tarifë 40 euro për çdo natë qëndrimi të kamionëve nga Shqipëria, duke rritur në mënyrë të konsiderueshme kostot për eksportuesit shqiptarë. Ndërsa këto tarifa u baraspeshuan nga Shqipëria, e cila nga viti 2014 filloi zbatimin e tarifës së skanimit në dogana në 22 euro për çdo deklarate doganore.

Më vonë, gjatë vitit 2019, qeveria e Shqipërisë dha me koncesion mirëmbajtjen e Rrugës së Kombit, ku automjetet e vogla që kalojnë në të paguajnë 5 euro me TVSH, autobusët 11 euro, kamionët e mesëm 16 euro dhe kamionët e rëndë 23 euro. Këto tarifa i rënduan më tej kostot për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve.

PROPOZIMI

Safet Gërxhalliu: Ekonomistët dhe ekspertët e dy anëve të kufirit duhet të hidhen në veprim. Nuk ka më kohë për të humbur, pasi politika ka dështuar të bashkojë ekonominë. Të mos merremi me arsyet pse ky bashkëpunim mungon, por të ulemi të gjepmë zgjidhjet.

Grupet e ekspertëve duhet të ulen dhe të hartojnë një program të përbashkët, ku në themel të jetë harmonizimi i taksave dhe tatimeve, njësimi i programeve arsimore, politikave dhe zhvillimit në shërbim të tregut të përbashkët dhe më pas qeveritë në të dy anët ta kenë në krye të axhendës.

TREGTIA, PËRKEQË-SOHEZ POZICIONI I SHQIPËRISË

Këtë vit, Shqipëria përkeqësoi pozicionin tregtar me Kosovën, pasi eksportet u ulën dhe importet u rritën gjatë 10-mujorit 2024.

Në periudhën janar-tetor, volumi tregtar i Shqipërisë me Kosovën ishte 45 miliardë lekë. Kjo vlerë zuri 3% të tregtisë me jashtë të Shqipërisë (import + eksport), një pozicion i ngjashëm me vitin 2023.

Gjatë 10 muajve të 2024, eksportet shqiptare në Kosovë shënuan 31 miliardë lekë, me rënie 9.2%, ndërsa importet nga Kosova u rritën me 29%. Rritja e importeve nga Kosova u dominua nga mallrat e kompanisë Devolli në Shqipëri me birrën "Peja", prodhimet "Vita" dhe me tapicerinë e shtëpisë nëpërmjet "Comodita Home".



Importet nga Kosova arritën 13,4 miliardë lekë, rreth 130 milionë euro në 10-mujor, me rritje vjetore 29%.

Eksportet shqiptare në Kosovë shënuan 31.7 miliardë lekë, me rënie vjetore mbi 9%. Tkurrijen më të madhe e pati hekuri me rreth 25% për shkak të rënies së prodhimit në kompaninë Kurum në Shqipëri. Eksporti i zarzavateve shënoi rënie me vlerë me rreth 22%, si rrjedhojë e rënies së çmimeve dhe rënies së euros, e cila i ka vënë në vështirësi eksportet e Shqipërisë këtë vit.

Shqipëria ka suficit tregtar me Kosovën, por kjo pozitë shënoi rënie të dukshme këtë vit. Në 10-mujorin 2024, suficiti tregtar shënoi 18 miliardë lekë, me rënie 27% nga niveli 25 miliardë lekë që ishte vitin e kaluar.

Tregtia me Kosovën është shumëfishuar në dekadën e fundit. Gjatë vitit 2023, volumi tregtar u 5-fishua në krahasim me vitin 2008, kur u shpall pavarësia. Shkëmbimi tregtar mes Shqipërisë dhe Kosovës nisi pas përfundimit të luftës në vitin 2000.

Në rreth dy dekada tregti shihet se përfituesja më e madhe është Shqipëria, e cila eksporton më shumë se sa importon mallra në Kosovë. Në vitin 2023, vlera e mallrave që Shqipëria eksportoi në Kosovë ishte dy herë më e lartë se vlera e mallrave që importoi.

Eksportet shqiptare në Kosovë dominohen kryesisht nga materialet e ndërtimit, lëkurët dhe prodhimet e tyre dhe ushqimet, ndërsa importet nga Kosova përfaqësohen kryesisht nga materialet e ndërtimit, të cilat zënë gati 50% të importeve, ushqimet dhe produktet kimike dhe plastike.

Në vitin 2023, partnerët tanë kryesorë për eksportet ishin Italia (43%) duke u ulur me 10,2% krahasuar me vitin 2022, Kosova (9%) duke u rritur 8,3% krahasuar me vitin 2022 dhe Greqia (7%) duke u rritur 13,1%.

Ndërsa partnerët kryesorë të Shqipërisë për importet më 2023 ishin

Italia (22%) duke u ulur 5,9% krahasuar me vitin 2022, Kina (11%) duke u rritur 21,0% krahasuar me vitin 2022, Turqia (10%) duke u ulur 26,2% krahasuar me vitin 2022.

VIZITORËT NGA KOSOVA BRAKTISIN SHQIPËRINË

Marrëdhëniet Shqipëri – Kosovë në nivelin politik kanë njohur uljen, por qytetarët e dy anëve janë lidhur fort sidomos nëpërmjet udhëtimeve, bashkëpunimeve kulturore, sportit dhe muzikës.

Por suksesi turistik i Shqipërisë është zbehur gjatë sezonit të verës dhe fillimit të vjeshtës, të paktën nëse i referohemi atij që njihet si turizëm patriotik. Shifrat zyrtare konfirmojnë se në muajin gusht, rritja e shqiptarëve të Kosovës ishte thujse inekzistente, ndërsa në shtator hyrjet shënuan rënie me 19.2% në raport me shtatorin e një viti më parë.

Liberalizimi i vizave argumentohet të jetë një tjetër faktor që shtetasit e Kosovës kanë preferuar të eksplorojnë destinacione të reja në disa raste edhe nga Tirana, për shkak të linjave loë cost.

Por duket se nuk kemi të bëjmë vetëm me një zbehje të interesit të turizmit patriotik. Shifrat zyrtare tregojnë për një numër më të ulët të çekëve, një grup që vazhdimisht ka qenë me rritje dhe që ka pasur interes për turizmin e organizuar.

Nisi si turizëm patriotik pas luftës së Kosovës në vitin 2000, por tani shtetasit nga ana tjetër e kombit zotërojnë kërkesën për turizëm në Shqipëri, duke zënë një të tretën e totalit të vizitorëve të huaj.

Gjatë dekadës, numri i turistëve nga Kosova rritet me ritme dyshifrore, po gjatë këtij viti ato kanë shënuar rënie. Për shqiptarët për turizmin dimëror, destinacionet e Malit të zi dhe Maqedonisë së Veriut mbeten më të pëlqyera edhe pse Boga, Sharri dhe Brezovica janë po aq të bukura.

Turistët nga Kosova janë bërë furnitori kryesor i të ardhurave në sektorin shqiptar të shërbimeve. Strukturat akomoduese në zonën e Durrësit, Shëngjinit dhe Velipojës fillimisht janë ngritur për t'u përgjigjur kërkesës për turizëm nga Kosova.

Vit pas viti, kjo kërkesë ka qenë e qëndrueshme dhe në rritje, duke u shndërruar në një burim të sigurt të ardhurash për ekonominë tonë. Gjatë vitit pandemik 2020 ku lëvizjet u bllokuan për shkak të koronavirusit, shqiptarët nga Kosova mbajtën gjallë turizmin në Shqipëri dhe parandaluan në thellimin e humbjeve në sektor.

Me hapjen e Rrugës së Kombit në vitin 2009-2010, numri i udhëtarëve që hynë në Shqipëri u rrit ndjeshëm. Tani shtetasit nga Kosova, përveç pushimeve të verës, nisën të vizitojnë Shqipërisë masivisht edhe për fundjava, duke u bërë burimi kryesor i të ardhurave edhe për disa qytete jobregdetare si Gjirokastra, Berati dhe Korça, etj.

Të dhënat zyrtare për hyrjen e turistëve nga Kosova datojnë pas vitit 2016, por të dhënat më të hershme për hyrjen e turistëve në rrugë tokësore tregojnë se pas përfundimit të Rrugës së Kombit, fluksi i tyre u rrit shpejt.

NACIONALIZMI EKONOMIK DHE PËRPARËSITË E BASHKËPUNIMIT

Përtej deklaratave për bashkëpunim dhe vullnet të mirë, në themel shqiptarëve në të dy anët e kufirit u mungon nacionalizimi ekonomik. Kjo shihet qartë te mungesa e besimit që konsumatorët e dy shteteve kanë te mallrat e njëri-tjetrit.

Jo vetëm që nuk ka besim por në shumë raste, ka edhe diskriminim. Profesor Safet Gërxhalliu ka vënë re se në Shqipëri, për të njëjtin produkt, preferohen më shumë kompanitë ital-

ianë dhe greke se sa ato nga Kosova.

Ndërsa Përparim Tushaj, nga ConsultingALB, thotë se kompanitë e Kosovës nuk kanë mundur të çajnë në tregun e Shqipërisë dhe shpeshherë janë detyruar të bashkëpunojnë ose të bëjnë ortakëri me bizneset atje për të shitur produktet e tyre.

Ndërsa ndryshe ndodh me mallrat shqiptare në Kosovë. Nafta e prodhuar në Shqipëri shitet masivisht në Kosovë dhe gjithashtu kompanitë shqiptare janë të pranishme në sektorët e financave dhe ndërtimit.

Në kontekstin fiskal, Shqipëria ka barrë më të lartë fiskale se Kosova. Shqipëria ka TVSH 20% ndërsa Kosova ka sistemin dy nivelesh 18 dhe 10%. Tatimi mbi fitimin për bizneset me xhiro vjetore mbi 50 mijë euro në Kosovë është 10%, ndërsa në Shqipëri, bizneset e mëdha taten me 15%.

Kosova ka një sistem më të butë progresiv për pagat se Shqipëria sidomos për nivelet më të larta dhe ka shumë më të ulëta se Shqipëria taksat e punës. Përpos shumë ngjashmërive në strukturën ekonomike, mentaliteti është i njëjtë në të dy anët e kufirit dhe këto elemente janë të mjaftueshme për të krijuar një treg të përbashkët unik.

Kosova ka një sipërfaqe 11 mijë kilometër katror dhe popullsia prej 1,6 milionë banorësh, Shqipëria ka një sipërfaqe prej 28 mijë kilometër katror dhe popullsia prej 2,4 milionë banorësh.

Nëse do të unifikohehin rregullat e tregtisë dhe taksat, si dhe politikave ekonomike tregu i përbashkët do të kishte rreth 4 milionë konsumatorë, në një territor prej 39 mijë kilometrash katror. Në këtë mënyrë, shqiptarët do të krijojnë bashkësinë më të madhe në Rajon pas Serbisë.

Duke pasur ende forcën e punës në kulmin e produktivitetit, Kosova dhe Shqipëria në një treg unik do të ishin një ofertë joshëse për kompanitë e huaja se në aspektin e tregtar, ashtu dhe në prodhim e manufakturë.

Kjo dëshirë e hershme e bizneseve për një treg unik në fakt nuk është bërë pjesë e agjendave të përbashkëta të qeverive, edhe pse spektaktli në këtë drejtim nuk ka munguar.

Por tani kur bota është përfshirë në pasiguri nga luftërat, shtete të vogla të tilla si Shqipëria dhe Kosova, do të duhen të bashkohen në tregje më shumë si nevojë emergjente për mbijetesë se sa për dëshirë patriotike.

Sfida

Tani kur bota është përfshirë në pasiguri nga luftërat, shtete të vogla të tilla si Shqipëria dhe Kosova, do të duhen të bashkohen në tregje më shumë si nevojë emergjente për mbijetesë se sa për dëshirë patriotike./ Monitor.



FOR SALE

RESTORANT PËR SHITJE
5 minuta nga Tower Bridge
I hapur prej vitesh
Me klientelë të garantuar



FOR SALE

RESTORANTI NDODHET NË NJË
ZONË SHUMË TË PASUR ANGLEZE

I PAJISUR ME TË GJITHA
LIÇENSAT



FOR SALE

PËR MË SHUMË INFO
KONTAKTONI:
07393453904

HARRY BAJRAKTARI

Më është bërë zemra mal nga lajmi se “K’cimi i Tropojës”, e thirrur ndryshe si “Valle veni”, është njohur tani edhe nga UNESCO si një “monument” i kulturës botërore. Urime Tropojës, Malësisë së Gjakovës, për arritjen e madhe kulturore kombëtare me përfaqësim të lartë ndërkombëtar!

Vallja e bukur dhe tradicionale u pranua edhe zyrtarisht këto ditë në “Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit” të UNESCO-s, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë.

“K’cimi i Tropojës”, kjo pasuri e çmuar dhe e rrallë kulturore shqiptare, që dëshmon vlerat universale të traditave tona të hershme të Tropojës Alpine, Dardanisë e Kombit, që prej këtij fundviti 2024 po renditet edhe si një simbol kombëtar i identitetit kulturor shqiptar, duke na bërë krenarë të gjithë shqiptarëve në atdhe e në Amerikë e kudo



tjetër në mërgata shqiptare në botë. Për këtë arritje të madhe të vendlindjes së të parëve të mi, dua të shpreh edhe vlerësimet e mirënjohjen time të veçantë: për të gjithë mbartësit dhe interpretuesit e “K’cimit të Tropojës” ndër brezat e

derisotëm e të nesërm; për Shoqatën “K’cimi i Tropojës”; për institucionet lokale e qendrore të Shqipërisë, për mediat shqiptare, për të gjithë lobuesit e kontribuuesit, duke theksuar se kjo na e rrit përgjegjësinë lokale e kombëtare

ZEMRA MAL

PËR “K’CIMIN E TROPOJËS”

shqiptare për të pasur angazhime e arritje të tjera të mbrojtjes e vazhdimësisë së saj.

Tropoja ka edhe një tjetër arritje të madhe lokale e kombëtare, kur “Lumi i Gashit” u bë pjesë në Listën e Trashëgimisë Botërore të Njerëzimit (kulturë materiale) të UNESCO-s.


Arritja e Tropojës me “K’cimi i Tropojës”, si një arritje kombëtare, me promovim ndërkombëtar e mbrojtje nga UNESCO, merr rëndësi të veçantë sepse deri më sot në Listën e Trashëgimisë Botërore (kulturë jomateriale) në UNESCO janë vetëm dy nga pasuritë kombëtare shqiptare:

Iso Polifonia Labe (2005, 2008) dhe Xhubleta (2022). Është pa dyshim një vlerësim i merituar për Tropojën e mbarë Malësinë e Gjakovës, një krahinë, e cila shpesh është përmendur për patriotizëm dhe virtytet më të larta njerëzore, që ka luajtur rol në historinë e popullit shqiptar. Por që ka qenë gjithmonë edhe burim i një folklori të mrekullueshëm, me valle, këngë, muzikë, instrumente muzikore, veshje të bukura karakteristike etj..

Ky vlerësim duhet t’u japë zemër shqiptarëve që të punojnë për ta ruajtur folklorin e tyre, për ta pasuruar. Kjo bëhet duke mos e lënë të harrohet. Duke ia mësuar brezit të ri. Duke treguar krenari e dashuri për traditat tona.

Kur fillon “Vallja e Venit”, me ritmin që jep tupani, me bukurinë e çiftelisë dhe fyelli, me valltarët e me shtatin e lartë dhe veshjet e bukura tradicionale ta mbushin zemrën me gëzim. Tani këtë “K’cim të Tropojës” e njuh dhe është e vendosur që ta mbrojë e gjithë bota. Urime!

Kur fillon “Vallja e Venit”, me ritmin që jep tupani, me bukurinë e çiftelisë dhe fyelli, me valltarët e me shtatin e lartë dhe veshjet e bukura tradicionale ta mbushin zemrën me gëzim. Tani këtë “K’cim të Tropojës” e njuh dhe është e vendosur që ta mbrojë e gjithë bota. Urime!



EMIN AZEMI

Gjuha shqipe është mjet komunikimi i 35 për qind të popullatës së Maqedonisë së Veriut. Nisma për rishikimin (lexo: cungimin) e ligjit për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe, nuk është asgjë tjetër pos hapje e një fronti të panevojshëm me shqiptarët, kostoja finale e të cilit do të ishte destabilizimi i vendit.

Inicimi në Gjykatën Kushtetuese që ka për synim rishikimin (lexo: cungimin) e Ligjit të gjuhëve, u bë me presion politik maqedonas.

Pa humbur kohë, që sot, duhet të artikulohej një presion tjetër politik (shqiptar), përmes një Deklarate politike, që si synim do të kishte parandalimin e rrënimit të ko-

NISMA PËR RISHIKIMIN E PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE – PROJEKT DESTABILIZUES



hezionit ndërretnik..

Nëse Marrëveshja e Ohrit parandaloi skenarët për zhbërjen e Maqedonisë, tani me rishikimin e Ligjit të gjuhëve, synohet rikthimi i Maqedonisë para kohës së Marrëveshjes së Ohrit, gjegjësisht para konfliktit. I bie, që dikush e ka një projekt të caktuar, i sponsorizuar nga brenda dhe jashtë, por në frymë antieuroatlantike, që këtu të ketë destabilizim, sepse vetëm kështu mundet gjoja t’u iket obligimeve që i ka marrë Maedonia për

ndryshime kushtetuese para anëtarësimit në BE.

Pak para pranimit të Maqedonisë në OKB (8 prill 1993), u pat inskenuar ngjarja e përgjakshme e Bit Pazarit, (7 nëntorit 1992), e cila u përdaor nga nomenklatura politike e Gligorovit për përshpejtimin e procesit të pranimit të shtetit në OKB.

A mundet të përdoret si alibi për ndonjë ide a projekt pasues, edhe ky presion politik për të ndërhy në Ligjin për përdorimin e gjuhëve?!

Sepse kjo rastësisht nuk po ndodh!

Ligji i gjuhëve, edhe si i tillë me plot të meta, po i pengon elitës politike maqedonase. Politikanët shqiptarë nuk duhet të bijnë në grackën e kësaj loje politike, sepse nëse ky ligj qenka me defekte, atëhere pse para 11 dhjetorit nuk mblidhen 32 deputetët shqiptarë dhe të pakicave (ose deputetët e partive në pushtet) që të amandamentojnë këtë ligj, duke propozuar zgjidhje tjera përmes amandamenteve plotësuese

që do të krijoheshin kushte për një përdorim zyrtar më kualitativ dhe kuantitativ të gjuhës shipe.

Lehtë është të kritikosh ligjet e këqija, por si duket është shumë e vështirë të bindësh VMRO-në të sjellësh ndonjë ligj pak më i mirë se ai i keqi.

Maqedonisë së Veriut nuk iu kanë dashur pikërisht në këtë fazë hapja e temave të tilla që acarojnë klimën e besimit ndërretnik, ndërkohë që bota ndodhet para një rreziku shumë më të madh, si pasojë e konflikteve aktuale dhe atyre që mund të shpërthejnë në të ardhmen.

Gjuha shqipe është mjet komunikimi i 35 për qind të popullatës së Maqedonisë së Veriut. Nisma për rishikimin (lexo: cungimin) e ligjit për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe, nuk është asgjë tjetër pos hapje e një fronti të panevojshëm me shqiptarët, kostoja finale e të cilit do të ishte destabilizimi i vendit.

A do të lejtohet, që ky projekt destabilizues të triumfojë dhe të gjitha premtimet parazgjedhore për zhvillim ekonomik e social të zëvendësohen me fitilaqa për dhez-

IRENA BEQIRAJ

“INDEKSI” I MEDIAVE SOCIALE TË NDALUARA!

Para se të shpikëj shtypshkronja, librat ishin të papërbalueshëm. Prodhim i tyre bëhej i mundur vetëm prej subvencionimeve të Kishës Katolike, e cila ruante kështu monopolin mbi dijen. Shtypshkronja jo vetëm i bëri librat e përbalueshëm për klasën e tregtarëve në mesjetë, por mundësoi që bibla të botohej në gjuhë të tjera përveç latinishtes.

Por shtypshkronja nuk ndryshoi vetëm gjuhën e librave, ajo po ashtu transformoi edhe stilin dhe tendencën e debatit. Debatet skolasitike të mesjetës te cilat ishin te ashpra por të edukuara u zëvendësuan nga debate teologjike të mbushura me zhargon dhe që padyshim ishin më teatrale. Reagimi i institucionit katolik ndaj kësaj epoke të re ishte i shumëanshem, por vlen të përmendet krijimi i Indeksit i Librave të Ndaluar; Brenda këtij indeksi u përfshijnë shumë nga veprat e rëndësishme të kulturës perëndimore, nga Niccolò Machiavelli dhe René Descartes te Galileo Galilei dhe Immanuel Kant.

Thonë që kur historia harrohet ajo përsëritet. Në 15 vitet e fundit një ndryshim i madh u shfaq ngadalë: shoqëria politika, ekonomia, por mbi të gjitha mendja njerëzore po riformëzohet nën pushtetin transformues të mediave sociale. Edhe pse mediat sociale kanë revolucionarizuar mënyrën sesi ne ndërveprojmë me njeri tjetrin, për të manaxhuar efektet negative të saj, ne po kthehemi tek “indeksi” por kësaj here i mediave sociale të ndaluara!

Të mbyllim tik tok-un, edhe të lejojmë Instagram-in? Të mbyllim Instagram-in edhe të lejojmë Facebook-un? Të mbyllim Facebook-un edhe të lejojmë vetëm kanalet televizive, ku dhuna verbale e fizike,



ekzibicionizmi seksual, vulgaretit ekstrem i të folurit, dhe humoristët që rrallë ngrihen mbi humorin e rrugës, janë bërë të zakonshme? Apo të mbyllim televizionet por të lejojmë podcastin Kryeministrit ku intervistohen shumë nga krijuesit e kësaj oferte irracionale masive?

Nëse teknologjia ndihmon ose jo qytetarët e zakonshëm, nuk varet vetëm nga natyra e teknologjisë, por nga mënyra sesi përdoret kjo teknologji në shoqëri. Nëse pesëmbëdhjetë vitet e fundit, nuk keni jetuar

nën një shkëmb e keni kuptuar se sistemet e të gjitha mediave sociale shpërblejnë si financiarisht edhe psikologjikisht, vetëm veprimet e njerëzve që tërheqin vëmendjen e përdoruesve të tjerë.

Ekonomia e vëmendjes ose “grushti i shtetit” i marketingut të shekullit 21, është në kërkim të vazhdueshëm të videos apo imazhit viral të rradhës. Njerëzit qajnë qeshin, dashurojnë tradhëtojnë, martohen, mbetet shtatezënë, ndahet, urrehen, shahen pse jo edhe vriten për pak më shumë

vëmendje.

Edhe pse komodifikimi edhe normalizimi i dhunës injorancës edhe vulgaretit është algoritmi bazë i promovimit në media sociale per fatin tonë të keq ky trend nuk filloi edhe nuk është i kufizuar vetëm te mediat sociale. Përshebull televizioni në prime time shfaq dhunë çdo natë. Psikopatët dhe vrasësit serialë portretizohen si protagonistë. Ndërsa gratë janë shpesh objektivi i kësaj dhunë të sëmurë.

Formatet televizive që kanë pushtuar ekranet tona janë te mbushura me modelet e përtacëve funksional që kërkojnë të pasurohet nëpërmjet vëmendjes ndërsa inkurajojnë cektësinë edhe materializmin. Për të gjithë këtë ofertë kaq racionalisht irrituese, ka një kërkesë te madhe emocionalisht të pranueshme. Natyra njerëzore magjepset nga shkeljet e normalitetit pasi ato janë hipnotike për t’u parë e ndjekur.

E pra, media në terësi është lejuar të lulëzojë si një treg që mund të plotësojë nevojat më të dobëta e më të errta të natyrës njerëzore, si një treg që shpërblen vulgaretin, mashtrimin dhe injorancën, duke i siguruar krijuesve të kësaj oferte shumë para e famë, madje ne vende si Shqipëria edhe një intervistë në podcastin e Kryeministrit.

Teknologjia na ka paisur të gjithëve më mundësinë për t’u shprehur, për të treguar kush jemi dhe çfarë vlerësojmë. Me anë të saj ne kemi mundur të zgjerojmë komunitetin të cilit përkasin. Nëse shtypshkronja theu monopolin e kishës mbi dijen, mediat sociale, thyen oligopolin komod të shtypit edhe trasmetimit mbi informacionin. Sot për shkak po të teknologjisë ne mund të aksesojmë në çdo kohë podcaste, e blogje interesante nga të cilat gjithë shoqëria mund të mësojmë shumë.

E pra problemi nuk janë mediat sociale, por moskuptimi masiv, edhe keqpërdorimi i hershëm i marrëdhënies reciproke midis mbrojtjes së shoqërisë nga mediat dhe fuqizimit të saj po prej tyre.

KIM MEHMETI

BDI-ja dështoi politikisht sepse drejtuesi i saj nuk merrej me hallet e shqiptarëve të Maqedonisë, por me çështjet globale dhe me mbylljen e suksesshme të ‘Botës Serbe’. Pra ai angazhohej për atë që nuk e kishim votuar përkrahësit e tij: si ta forconte Maqedoninë dhe si ta pëlqenin diplomatët e huaj në Shkup, por ndërkohë duke i defaktorizuar shqiptarët e kë-tushëm.

VLEN-i që sot bënë pjesë në qeverinë e Republikës së Maqedonisë Veriore, është tërësisht i pavlerë për shqiptarët e kë-tushëm dhe atë nuk mund ta shpëtojë as e tërë Lëvizja Vetëvendosje e jo më vetëm kryetari i saj - i cili, kalimthi thënë, do mbetet shpresa e rinisë kosovare dhe Kryeministri më i ndershëm e më i mençur që ndonjëherë ka pasur Kosova - sepse nuk

dinë të mendojë shqip, gjë që e pengon të vërejë se vendin e drejton një VMRO-DPMNE maqedonase e cila vuan nga mendësia politikë serbe dhe si e tillë Maqedoninë e bënë ‘Serbosllavi’ të vogël.

Pra ‘Vlenistët’, duke u marr vetëm me ndarjen e posteve dhe të tenderëve, nuk shohin se janë ‘vasal’ të pushtetarëve maqedonas, të cilët jo vetëm që janë analfabet politikë, por edhe të verbëruar nga dashuria nda Vuçiqit, e që e bënë edhe më absurde përkrahjen e tyre nga Prishtina zyrtare.

Por ku ta dish, mbase edhe nuk ka si të veprojnë ndryshe drejtuesit e partive të shqiptarëve të Maqedonisë në rrethana kur mëmëdheu i tyre – Shqipëria, ka Kryeministër kryesuesin e ‘aleancës së qelbësirave’, kur në Shqipëri ende është e paqartë nëse PIKtori i drejton bandat kriminele, apo ato e drejtojnë atë.

Por ku siç duket nuk është e largët dita kur shqiptarët e atjeshëm do i falënderojnë hajdutët e ‘Rilindjes’ pse kanë qenë të ‘kujdesshëm’ ndaj popullit e atdheut dhe ata nuk kanë vjedhur aq sa kanë pasur mundësi dhe aq sa u është lejuar.

SHQIPTARËT NDËRTOJNË MAQEDONINË QË NUK I DO ATA SI MURATORË TË SAJ!



**Ç'I HYNTE NË PUNË
SPAK-UT SE ARTAN
HOXHA KISHTE
ARRITUR TË
MANIPULONTE EMI-
SIONIN E FEVZIUT,
APO ELTON QYNO
LAJMET E KARLO
BOLINOS? MOS VALLË
KËTO QENË KRIMET
MË MOSTRUOZE TË
BANDËS SË SUEL
ÇELËS?**

ANDI BUSHATI

Po të bëhet një llogaritje e pasqyrimin mediatic të “goditjes spektakolare”, që SPAK ndërmoi ndaj bandës së Suel Çelës në Elbasan, vërehet me lehtësi një anomali.

Shumica e titujve i dedikohen “korruptimit” të gazetarëve Artan Hoxha e Elton Qyno, mënyrës se si ata “prodhonin lajme për llogari të bandave”, në këmbim të parave që mermin prej tyre. Për të shkuar edhe më tej, një tjetër tymnajë u ngrit me të madhe edhe rreth vrasjes së mundshme të Saimirit të Stopit.

Po të lexoje përshtjellimin që krijuan këto “zbulime” ngjante sikur “spin doctors-at” e SPAK e kishin arritur qëllimin. Duke pompuar emrat e gazetarëve ata e patën përlllogaritur përmasën e zhurmshme që kjo ngjarje do të merrte, aq sa për të lënë në heshtje çdo aspekt tjetër.

Pak, fare pak, zëra vigjilentë u kujdesën të ngrenë pyetjen: Po pse duhej të ishte prioritet i prokurorëve të posatshtëm, qoftë edhe nëse ishte e vërtetë që Artan Hoxha paskësh manipuluar për llogari të një bande? Nëse kjo ka ndodhur, ajo përbën pa asnjë dyshim një përdhosje të moralit dhe profesionit të gazetarit, si nga ai, apo qoftë edhe nga Qyno, por deri këtu. Ata as kanë vuarë njeri, as kanë nxjerë dikë në pritë, as kanë shitur vota, drogë apo armë. Mëkatet e tyre duhet të qenë në fundit në klasifikimin e shqetësimeve të prokurorëve, nëse ata nuk kishin qëllim të vërtetonin teorinë e “mediave të kazanit”.

Pra, ç'i hynte në punë SPAK-ut se Artan Hoxha kishte arritur të manipulonte emisionin e Fevziut, apo Elton Qyno lajmet e Karlo Bolinos? Mos vallë këto qenë krimet më mostruoze të bandës së Suel Çelës?

Këto dilema bëhen edhe më të mëdha po të vëzhgohet përmasa që mori episodi i vrasjes në tentativë të drejtuesit të Stop. Po të lexohet dosja me vëmendje shikohet që ajo është një budallallëk me brirë. Suel Çela duket hapur që tallet me atë gjyqtaren



e neveritshme që ia kërkon këtë edhe as nuk ka ndërmend të qëllojë mbi gazetarin. Edhe vetë Saimir Kodra e pohoi me modesti se ai as nuk kishte ndjerë, as nuk kishte marrë kurrë kërcënime. Pra kjo fluskë qe thjeshtë qesharake për të fituar përmasat që mori.

Po pse atëherë i'u dha kaq hapsirë në dosje këtyre emrave që dihej se do të shkaktonin rokopujë dhe pse rripat e transesionit të prokurorëve në media e shumfishuan atë?

Përgjigjja e këtyre pyetjeve gjendet po të lexohen me vëmendje në 262 faqet e dokumentit që “rodhi” drejtpërdrejt nga zyrat e SPAK.

Aty flitet për shembull për një biznesmen të quajtur Bujar, ose Marsel Shega që është i lidhur ngushtë me bandën e Suel Çelës. Por, po të shihet aktiviteti i tij, ai është favorizuar në marrjen e shumë tenderave shtetërore dhe punëve publike. Kompanitë e tij

AJO ÇKA SPAK FSHEH NË DOSJEN E ELBASANIT

Viola Green dhe Wonder Green kanë përfituar nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, në Elbasan, Berat, Peqin, Kuçovë duke u bërë kështu kanali përmes të cilit banda e Elbasanit ushqej me të ardhura publike.

Në dosje shihet gjithashtu se dy nga të arrestuarit si pjestarë të bandës, kanë arritur të katapultojnë mortën e tyre, direkt e në paradhomën e Edi Ramës.

Adelajda Roka mban prej një viti detyrën e drejtoreshës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, nga kalojnë të gjitha lejet e ndërtimit në vend. Në kontrollin e banesës që i'u bë njërit prej vëllezërve, thuhet se u gjetën edhe plane biznesi që kalonin nga Rama dhe e motra, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis kriminalitetit dhe një sektori fitimprurës të rregulluar drejtpërdrejt nga kryeministri.

Panorama merr formë të plotë po të kujtojmë se njëri nga këta vëllezër, dhe disa nga shokët e tij të armëve, ishin ata që u akuzuan se masakruan Lulzim Bashën dhe përkrahësit e tij, në mes të Elbasanit në incidentin e famshëm të ditës së verës, në 2021-shin. Ishin po të njëjtët që emri u ka dalë në blerjen e votave, marrjen e kartave të identitetit dhe mbylljen e zyrave të LSI-së gjatë fushatës së fundit elektorale.

Pra, le ta përmbledhim pak. Banda kriminale e Elbasanit, jo vetëm terrorizonte në paprekshmëri të plotë qytetin, jo vetëm korruptonte policë e gjyqtarë, por partia në pushtet kujdesej ta furnizonte dhe me para publike. Ajo merrte tendera dhe filtronte lejet e ndërtimit që nënshkruan me dorën e tij kryeministri. Përse i merrte këto favore? Për arsyen e thjeshtë se ishte aktive në manipulimin e zgjedhjeve. Ilustrim më të mirë sesa i bën kjo dosje devizës së Ramës: “vjedhin

Shqipërinë për të vjedhur vota dhe vjedhin vota për të vjedhur Shqipërinë”, nuk ka se si të ketë.

Pikërisht për këtë arsye, për të fshehur këtë të vërtetë të thjeshtë duhej shpikur një zhurmë e madhe. Prandaj turmave i'u hodhën pa mëshirë emrat Artan Hoxhës dhe Elton Qynos si një brum i mirë për të ushqyer nofullat e pamëshirshme të mekanizmit mediatic.

Natyrisht, mëkatet e supozuara të këtyre dy gazetarëve, që nuk e di a duhen më të quhen të tillë, nuk janë të vogla, por ato janë krejt të papërfillshme në raport me krimin real që gjendet në atë dosje. Pikërisht për këtë të parët u përdorën për të mbrojtur të dytin. Dhe për këtë SPAK realisht duhet përgëzuar, pasi ka përqaftuar më së miri filozofinë që mbretëron në Shqipëri së paku prej një dekade, për të arritur me anë të komunikimit, atë që nuk bën dot me punë.

Sulmet e fundit në Kosovë ende nuk janë zbardhur. Por një gjë është e qartë, Beogradi nuk është i interesuar për stabilitet në Kosovë. Ndërsa BE po “vëzhgon” gjendjen.

ALEXANDER RHOTERT

Javën e kaluar, Republika e Kosovës përjetoj një seri sulmesh: së pari, granata dore shpërthyer pranë stacionit policor të Kosovës në Zveçan në veri të vendit, i populluar kryesisht me serbë. Disa ditë më vonë, një granatë dore shpërtheu në bashkinë e Zveçanit. Menjëherë pas kësaj, një shpërthim dëmtoi një kanal të rëndësishëm uji jo larg qytetit të Mitrovicës, i cili është i rëndësishëm për furnizimin me ujë të banorëve të veriut të Kosovës dhe për ftohjen e termocentralit.

Ende është e paqartë se kush qëndron pas sulmit. Qeveritë e Serbisë dhe Kosovës akuzojnë njëra-tjetrën për përgjegjësi. Por sulmi në kanalin Ibër-Lepenc u dënua nga Bashkimi Evropian si një “sulum terrorist”: “Është një akt i neveritshëm sabotimi kundër infrastrukturës kritike civile të Kosovës” – tha shefi i politikës së jashtme të BE-së në largim, Josep Borrell.

Pavarësisht nga rezultati i hetimeve, mund të thuhet se nga viti 2022 ka pasur një sërë veprimesh dhe kërcënimesh të dhunshme nga Serbia kundër Kosovës. Në shtator të vitit të kaluar, një grup paraushtarak i infiltruar nga Serbia dhe i armatosur me armët e forcave të armatosura serbe sulmoi policët e Kosovës.

Një polic dhe tre sulmues u vranë në një “akt terrorist” të dënuar nga BE. Brukseli kërcënoi me sanksione, por kaq ishte. Më vonë, presidenti serb Aleksandar Vuçiq i zhvendosi forcat e tij të armatosura afër Kosovës. Vetëm ndërhyrjet e SHBA-së dhe NATO-s e detyruan Vuçiqin të ndalonte tanket e tij. Një skenar i ngjashëm ka ndodhur edhe në dhjetor 2022.

“Bota serbe”

Gjatë ndërmjetësimit të BE-së në mars 2023, Vuçiqi dhe kryeministri i Kosovës Albin Kurti ranë dakord verbalisht për të përmirësuar marrëdhëniet. Në të njëjtën mbrëmje, i pyetur se kur do të nënshkruhet marrëveshja, Vuçiq tha në televizion: “Kam dhimbje të padurueshme në dorën time të djathtë, e unë mund të nënshkruaj vetëm me dorën time të djathtë. Pritet që këto dhimbje të zgjasen edhe në katër vitet e arshhme”.

Në maj të vitit 2023, pasuan sulmet serbe ndaj forcës paqeruajtëse të NATO-s, KFOR-it, në të cilat u plagosën 90 ushtarë, disa prej tyre

ANALIZA NË DW/ A PO E INKURAJON BE SERBINË TË SILLET NË MËNYRË AGRESIVE?



rëndë. Pasi KFOR-i u rrit në gati 5000 ushtarë në fund të vitit të kaluar, dhuna në Kosovë u zvogëlua.

Në qershor të vitit 2024, në Beograd u mbajt një konferencë ndërqeveritare nën udhëheqjen e Vuçiqit me qëllim zbatimin e konceptit “Bota Serbe”. Nacioni bazohet në termin “Bota Ruse”.

“Bota Serbe” është një përshkrim i ri i projektit “Serbia e Madhe” që presidenti serb Slobodan Millosheviq zbatoi gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet 1990, domethënë bashkimin e të gjitha zonave të banuara nga serbët.

Lavdërim nga Presidenti i Komisionit Evropian

Në prill të vitit 2024, komandanti suprem i NATO-s për Evropën, gjenerali amerikan Christopher Cavoli, paralajmëroi urgjentisht për konflikte të reja të armatosura në Ballkanin Perëndimor. Rusia, tha ai, po përdor aktorët serbë për të ndezur tensionet në rajon dhe për t’i kthyer grupet e ndryshme etnike kundër njëri-tjetrit.

“Sulmet ndaj policëve të Kosovës dhe grumbullimi i trupave serbe në kufirin me Kosovën veriore përfaqësonin kërcënimin më të madh të dhunës ndërshtetërore që nga fundi i luftës së vitit 1999 dhe demonstruan një nivel shqetësues kërcërimi në rajon,” tha Cavoli.

Këto ngjarje nuk u diskutuan gjatë

vizitës së Presidentes së Komisionit Evropian Ursula von der Leyen dhe bisedës me Vuçiqin në Beograd në tetor 2024. Vuçiq dhe qeveria e tij u lavdëruan dhe u shpërblyen në mënyrë eksplicite: Von der Leyen konfirmoi se Vuçiq kishte bërë një “punë të shkëlqyer” me një “program të shkëlqyer të reformave” dhe paralajmëroi ndihmë financiare për Serbinë në qindra milionë euro.

“I dashur Aleksandar,” tha von der Leyen, “ju keni treguar se jeni të vendosur të nxisni për reforma, veçanërisht në aspektin e shtetit ligjor dhe demokracisë. Ju keni treguar se fjalët tuaja pasohen nga vepra!”

Modaliteti hibrid

Lavdërimet e presidentit të BE-së janë në kontrast të plotë me analizat e shumta të instituteve dhe organizatave joqeveritare të njohura. Sipas Projektit Botëror të Drejtësisë, Serbia renditet e 94-ta midis Beninit dhe Kinës për sa i përket sundimit të ligjit. Të gjitha vendet e krijuara nga shpërbërja e Jugosllavisë janë në pozitë më të mirë, ndër to edhe Kosova, e cila është në vendin e 58-të.

Sipas Transparency International, Serbia renditet e 104-ta nga 180 vende në indeksin e korrupsionit. Dhe Human Rights Watch përshkruan një pamje të zymtë të lirisë së medias dhe vëzhguesit e zgjedhjeve i kanë kritikuar zgjedhjet e dhjetorit 2023 – si as të lira dhe as të drejta. Freedom House e ka quajtur prej kohësh

regjimin serb “hibrid”, do to thotë diçka midis demokracisë dhe autokracisë.

Qeveria serbe aktualisht po merr masa shtypëse kundër shoqërisë civile pas protestave kundër minierave të planifikuara të litiumit dhe rrënimin në stacionin hekurudhor në Novi Sad, në të cilat vdiqën 14 persona. Në të njëjtën kohë, regjimi i Vuçiqit, i cili po reagon gjithnjë e më me nervozizëm nga brenda, po intensifikon në mënyrë dramatike kontaktet me qeveritë e Rusisë, Kinës, Bjellorusisë dhe Iranit në nivel ushtarak, sigurisë, në nivelin politik dhe ekonomik. Duket se mungesa e kritikave nga BE-ja, së bashku me ndihmën e madhe financiare të pakushtëzuar, po arrin pikërisht të kundërtën e qëllimit të dëshiruar, që është qetësimi i Ballkanit Perëndimor.

Sundimi i drejtësisë dhe litiumi

“Siç e dini, Serbia nuk është vetëm një partner strategjik, por edhe një aleat i Rusisë,” i tha i besuari më i afërt i Vuçiqit, zëvendëskryeministri Aleksandar Vulini, presidentit rus Vladimir Putin në një takim në Vladivostok në shtator, i cili u sanksionua nga SHBA për afërsinë e tij me Moskën.

Në një intervistë për “Rusia Today” në kuadër të samitit të BRICS, Vulini u ankua edhe për përfaqësuesit e BE-së dhe NATO-s, të cilët vazhdimisht i bënë thirrje qeverisë serbe të mbështesë sanksionet e BE-së kundër

Moskës. Megjithatë, Vulini i premtoi audiencës ruse se Serbia nuk do të bënte kurrë një “tradhti të madhe” të tillë. “Jam krenar për marrëdhëniet e mia me Rusinë dhe do të luftoj deri në ditën e fundit të jetës sime për t’i afruar ato”.

Që kur kancelari gjerman Olaf Scholz nisi një marrëveshje miliarda eurosh për litium midis Brukselit dhe Beogradit në korrik, gjërat kanë filluar të ziejnë në Ballkanin Perëndimor. Një ish-diplomat gjerman dhe ekspert për Ballkanin, i cili dëshironte të mbetej anonim, tha se BE e sheh tani Ballkanin vetëm si “një rajon nga i cili vijin kujdestarët” me “burime të tilla si litiumi”. “Autokratët si Vuçiq” janë të dobishëm këtu, sepse ata mund të shtyjnë më së miri projektet e diskutueshme vendase si biznesi i litiumit.

Një ekspert për Ballkanin në Universitetin e Gracit, profesor Florian Bieber, komenton në llogarinë e tij X: “Sot, BE dhe Gjermania kanë shkëmbyer demokracinë, shtetin e së drejtës dhe perspektivën e anëtarësimit të Ballkanit në BE me litium.”

Në Serbi nuk ka institucione apo media të pavarura, as vend për një shoqëri civile kritike”. Siç është paralajmëruar, Vuçiq do të takohet me kancelarin Olaf Scholz të martën e ardhshme në Freiberg të Saksonisë. Tema e takimit është “Shfrytëzimi i qëndrueshëm i litiumit”. /DW

ENVER ROBELLI

Ish-kancelarja gjermane ka botuar autobiografinë e saj me titullin kumbues, “Liria”. Në vend të reflektimit për disa gabime të saj – sidomos ndaj Ruisë – ajo fajin e kërkon vetëm te të tjerët. Në librin e Angela Merkelit përmendet disa herë edhe Kosova.

Së pari, për Ballkanin: në autobiografinë e saj prej 700 faqesh dhe me titullin “Liria” (Freiheit) ajo s’përmend me emër asnjë politikan të Ballkanit. Por Ballkani si rajon e si temë është i pashmangshëm.

Në vitin 2007, Vladimir Putini mbajti në Konferencën e Sigurisë në München fjalimin e tij sa të famshëm, aq famëkeq, ku akuzoi Perëndimin, mes tjerash, edhe për intervenimin kundër Serbisë më 1999. Putini tha se BE dhe NATO nuk mund ta zëvendësojnë OKB-në. Sa për sqarim për publikun shqiptar: deri më 2007 Rusia kishte marrë pjesë aktivisht në negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Pas fjalimit të Putinit në München, Rusia kaloi hap pas hapi në taborin e kundërshtarëve të ashpër të pavarësisë së Kosovës.

Pra, fjalimi i vitit 2007 paraqet kthesën e madhe të Moskës në politikën ndaj Perëndimit: nga kursi deri diku bashkëpunues në qasjen konfrontative. Lidhur me fjalimin e Putinit në München, Merkel shkruan: “Kisha mundësinë ta vëzhgoja mirë Putinin gjatë fjalimit të tij.

Fliste shpejt, pjesërisht duke shmanjur fjalimin e shkruar, të cilin në pjesën më të madhe, ndoshta e kishte shkruar vetë, ndoshta çdo fjalë”. Merkel nënvizon se e ka shqetësuar besimi i Putinit se është i pagabueshëm: “Asnjë fjalë për konfliktet e pazgjidhura para derës së tij në Nagorno-Karabah, Moldavi dhe Gjeorgji, kritikë ndaj ndërhyrjes së NATO-s në Serbi, por asnjë fjalë për krimet e tmerrshme të serbëve gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, asnjë fjalë për zhvillimet brenda vetë Ruisë”. Sa i përket ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, Merkel shkruan: “Si pjesë e operacionit NATO, ‘Allied Force’, forcat ajrore luftuan kundër trupave serbe dhe jugosllave të Sllobodan Millosheviçit. Ato ishin brutale ndaj popullsisë shqiptare në krahinën e Kosovës dhe e dëbuan atë për të penguar pavarësinë e Kosovës”.

Sipërfaqësore janë disa shënime të tjera për Ballkanin të Merkelit. Ajo lavdërohet për lançimin e Procesit të Berlinit duke e quajtur “sukses të madh” dhe vazhdon: “Kam qenë dhe mbetem e bindur se vetëm anëtarësimi i të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE mund të sigurojë një bashkëjetesë të qëndrueshme dhe paqësore në rajon. Sado e vështirë të jetë rruga deri atje, ajo duhet të ndiqet”.

Asnjë fjalë vetëkritike për afërsinë e saj me autokratët e Ballkanit, për de-

FAJIN E KANË TË TJERËT, APOLOGJIA E PABESUESHME E ANGELA MERKELIT



gradimin e rregullave demokratike sidomos në Serbi dhe Shqipëri, për shtypjen e mediave, për lidhjet e politikës me krimin e organizuar, për korrupsionin e madh. Në autobiografinë e saj, Merkel në vend të reflektimit për disa gabime të saj – sidomos ndaj Ruisë – fajin e kërkon vetëm te të tjerët. Edhe pasi Rusia aneksoi Krimenë, ajo e mbrojti ndërtimin e gazsjellësit “Nord Stream 2”, i cili kalonte nëpërmjet Detit të Veriut dhe anashkalonte Ukrainën dhe Poloninë. Kësisoj, Gjermania bëhej edhe më e varur nga gazi rus, ndërsa Ukraina dhe Polonia humbnin tarifën e transitit të gazit nëpër këto vende dhe ekspozoheshin edhe më shumë ndaj rrezikut rus – veçanërisht Ukrainën.

Varshava dhe Kievi kritikuan afërsinë e madhe të Gjermanisë me Rusinë, por Merkel nuk ua vuri veshin shqetësimeve të fqinjëve. Më 1 mars 2014 Merkel zhvilloi një bisedë telefonike me Putinin, të cilin e ballafaqoi me informatën se personat e armatosur, me uniforma të gjelbra dhe pa shenja shtetërore, të cilët pushtuan Krimenë, ishin rusë.

Putini e mohoi këtë. “Me këtë, siç u bë shumë shpejt e qartë, ai më kishte thënë haptazi të pavërtetën”, – shkruan Merkel. Pas kësaj gënjeshtre të Putinit, “ne ishim kundërshtarë”, tregon ish-kancelarja gjermane. Por, a kishte konsekuencë kjo rrenë e Putinit?

Jo! Gjermania vazhdoi me të vjetrën. Duke mos marrë seriozisht paralajmërimet amerikane, duke thënë se

SHBA-të janë kundër gazit rus, sepse do të shesë gazin e vet.

E vërtetë është që Washingtoni synonte të shiste gazin e vet, por kjo nuk ishte e vërteta e plotë. Paralajmërimet amerikane mbi rrezikun që bart më vete varësia gjermane nga gazi rus dolën të vërteta. Politika gjermane ndaj Moskës ishte kjo: të krijohet lidhje sa më të thella ekonomike me Rusinë në mënyrë që konfrontimet të bëhen të pamundshme. E kundërta doli e vërtetë: më 24 shkurt 2022, Rusia filloi agresionin gjithëpërfshirës ndaj Ukrainës.

Mjaft perfide është akuzë që Merkel ua bën Ukrainës dhe Polonisë për grykësi: “Edhe Polonia dhe Ukraina nuk e kundërshtonin në parim furnizimin e Evropës Perëndimore me gazin rus, por donin të përfitonin prej tij duke marrë tarifa transitit”.

Merkel e mbron edhe kundërshtimin e saj, që ia bëri planit për anëtarësimin e Ukrainës dhe Gjeorgjisë në NATO gjatë Samitit të NATO-s në Bukuresht më 2008. Ajo thotë se rrezikoi një përplasje të hapur me presidentin amerikan George W. Bush.

Këtë ajo nuk e bëri vetëm – krah saj ishte edhe presidenti francez Nicolas Sarkozy. Ndonëse Merkel ka argumente valide pse kundërshtoi hapjen e rrugës për hyrjen e Ukrainës në NATO – argumenti më i rëndësishëm i saj është se atëbotë shumica e ukrainasve ishte kundër përfshirjes në NATO, megjithatë pasojat e vendimit të saj janë katastrofale. Edhe nëse

ndokush pajtohet me kundërshtimin e saj në Samitin e Bukureshtit, pothuaj asnjë gjeostrateg nuk mund të kuptojë as Gjermaninë, as shtetet e tjera të fuqishme evropiane e deri diku as SHBA-të, që me vite refuzuan ta përkrahin Ukrainën ushtarakisht.

Kanë qenë këto shtete që pas shpëputjes nga Bashkimi Sovjetik e bindën Ukrainën t’ia dorëzojë Ruisë armët bërthamore. Po të ishte Ukraina fuqi atomike, diktatori në Kremlin do të mendohej dy herë nëse do fillonte pushtimin ushtarak të Ukrainës. Qasja e Merkelit se ka qenë pothuaj e pagabueshme, insistimi i saj se të tjerët nuk i kuptojnë apo nuk i kuptonin rrethanat është pjesë e betejës për të interpretuar historinë e qeverisjes së saj 16-vjeçare si kancelare. Në vitin 2015 ajo vendosi të mos refuzonte rreth 1 milion refugjatë nga Siria, të cilët erdhën përmes Ballkanit, Hungarisë dhe Austrisë pranë kufirit me Gjermaninë. “Wir schaffen das”, (do t’ia dalim), tha Merkel atëbotë. Për këtë fjalë ajo kritikohet, sepse integrimi i refugjatëve nuk po kalon pa vështirësi. Megjithatë, vendimi i Merkelit është një gjest i madh human. Pjesa më mbresëlënëse në këtë libër është ajo ku Merkel flet për 35 vjetet e saj të kaluar në diktaturën gjermano-lindore. Janë 35 vjet të jetuara në joliri. Pas një udhëtimit të paharrueshëm në Bavari dhe Austri në verën e vitit 1961, më 13 gusht mbarë familja tronditet kur sheh fillimin e ndërtimit të Murit të Berlinit. “Ne fëmijët e dinim që duhet të heshtnim”, shkruan ajo. Sepse në diktaturë çdo fjalë ‘e pavend’ mund të të çojë në

burg.

Merkel bën kompromise, por jo të tilla që e diskreditojnë. Ajo anëtarësohet në organizatën rinore të partisë komuniste, por nuk pranon të bëhet informatore e Stasi, shërbimit famëkeq sekret të Gjermanisë Lindore. Merkel bën një jetë kryesisht të heshtur në diktaturë, duke hulumtuar si fizikane. Studiuesi dhe publicisti britanik Timothy Garton Ash, një njohës brilant i historisë së Gjermanisë, ia bën këtë rezymë librit të saj: “Merkel i referohet shpesh librit të historianit Christopher Clark mbi origjinat e Luftës së Parë Botërore, ‘Somnabulët’ (gjermanisht: ‘Die Schlafwandler’, 2012) dhe thekson se duhet të shmangim një situatë ku, si në atë kohë (më 1914), mund të hynim në një tjetër luftë botërore pa e kuptuar fare. Tragjedia e historisë së saj është se, në përpjekjen për të shmangur gabimin që bënë udhëheqësit evropianë para Luftës së Parë Botërore, ajo bëri gabimin që hapi rrugën për të Dytën. (...) Kjo është pra historia e triumfit, por edhe e tragjedisë së një gruaje vërtetë jashtëzakonshme, të fortë, të matur, parimore dhe të ndershme nga Gjermania Lindore, e cila drejtoi Perëndimin. Kur përdoren fjalë të mëdha si triumf dhe tragjedi, Angela Merkel ka zakonisht simpatik të rrudhë supet dhe të nxjerrë një ‘Pffff!’ të lehtë përcmues. Sikur të donte të thoshte: ‘Mos më fol me këtë lloj krekosje burrash’. Por, nëse jeta e saj nuk është një triumf dhe ajo që po ndodh me Ukrainën nuk është një tragjedi, atëherë nuk e di çfarë mund të meritojë këta tituj”.

LUTFI DERVISHI

ME SY, VESH E MENDJE NGA VENECIA

Në një vend të krijuar nga konferenca e ambasadorëve të Fuqive të mëdha, në një vend ku dielli nuk lind pa miratimin e ndonjë komisioni ndërkombëtar, nuk mund t'i zësh besë askujt. Aq më shumë një politikani, deputeti, ministri apo gjyqtari!

Po a mund t'i besosh një mjeku?

Doktori më tha se nga një vakt në tjetrin duhet të kalojnë e pakta pesë orë. "Por," shtoi me ton serioz, për t'u siguruar, mund të kërkojsh një opinion të dytë. (Second opinion). Nuk e kuptova pse ma tha në anglisht këtë, ndoshta po më sugjeronte ndonjë klinike jashtë.

Ke ndonjë adresë ku mund të shkoj?

Aty ku shkojnë të gjithë, - tha, - te Komisioni Venecias.

Në fillim mendova se po bënte shaka, por jo. Në një vend ku politikanët, deputetët dhe madje edhe gjyqtarët kushtetues nuk marrin dot vendime pa pyetur Venecian, pse duhet të jetë ndryshe për stomakun tim? Në fund të fundit, është një çështje që lidhet me Kushtetutën e Organizmit të Njeriut.

Ndërkohë, po imagjinoj skenën: një anëtar i Komisionit të Venecias, i ulur në një zyrë të mrekullueshme mbi kanalet e famshme, merr një e-mail nga Shqipëria: "Kërkesë urgjente për opinion: A duhen 5 apo 6 orë pushim mes vakteve? A përbën shkelje nëse ha



më herët? A është njeriu sovran në marrjen e vendimeve për stomakun e tij?"

Dhe Venecia, me seriozitetin që e karakterizon, thërret një sesion emergjent. Si rregull në dhjetor. Diskutojnë, analizojnë, krahasojnë praktikën ndërkombëtare dhe pas një debati të gjatë, nxjerrin një opinion përfundimtar: "Pesë orë janë standardi minimal, por në raste emergjente, si në kohë fushate, mund të hanë dhe pas katër orëve e gjysmë. Megjithatë,

çështja i përket kompetencave jo vetëm të sovranitetit të stomakut, por edhe të aparatit tretës në tërësi. Çdo njeri është sovran për stomakun e tij, me përjashtim të ushqimeve që shkaktojnë shqetësim në stomak"

Tek e fundit kërkesa ime është legjitime se ka të bëjë me shëndetin, ndryshe nga ajo e deputetëve që në vend që të respektojnë ligjet që vetë i kanë miratuar, pyesin Venecian:

- "A mund të vazhdojmë të bëjmë

si të na dojë e bardha zemër, apo ka ndonjë kufi edhe për ne?"

- Nëse ka kufi për ne a nuk po kthehem te teoria e "sovranitetit të kufizuar" të Brezhnjevitet?

-A duhet të zbatohet vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo t'i diskutojmë si telenovelë në mbledhjet e grupit parlamentar?"

Dhe ç'të thuash për gjyqtarët kushtetues? Janë ata që duhet të zbatohet Kushtetutën, por çdo vendim e shoqërojnë me pyetjen: "A i pëlqen kjo Venecias?" Nëse

përgjigjja është "jo," atëherë duhet të rivotohet, të diskutohet, të riformulohet. Sepse, opinionin e Venecias ka peshë më të madhe se ai i Kushtetutës!

Nuk është çudi që një ditë të kërkojnë një opinion se kur duhet të nisë zbulimi i pemës së Vitit të Ri.

Dhe pas opinionit të dytë kush na pengon ne të kërkojmë një opinion, të tretë, të katërt...?!

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



Akoma nuk keni një website?

Dotech
website 

**Mos lejoni që Viti i Ri 2025
tu gjejë pa një website**

**Për çdo konsultim
mund të vini tek zyrat tona**

The 
Albanian

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**



AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI
NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD,
LONDON, E13 8HT**

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

SPINOZA NË ZUBIN-POTOK

VETON SURROI

Shpërthimi terrorist në kanal in Ibër-Lepenc është alarmi më i ndezur për të konsideruar që marrëdhëniet Kosovë-Serbi duhet të trajtohen brenda kontekstit të një zone evropiane të përbashkuar të sigurisë

1.

Dy ditë para se të ndodhte shpërthimi në kanal in e Ibër-Lepencit në afërsi të Zubin-Potokut isha në një konferencë për siguri të Ballkanit Perëndimor në Klubin e Oficerëve të Armatës Greke në Athinë. Sallës së plotë të ushtarakëve të interesuar dhe të diplomatëve e akademikëve, të cilët i njoh në tridhjetë vjetët e fundit, nuk kisha shumëçka të re për të shpjeguar nga hollësitë e përditshmërisë, por m'u duk me vlerë që të vlerësoja momentin historik nëpër të cilin po kalon regjioni me një thënie të bërë që në shekullin XVII nga filozofi holandez Baruch Spinoza. Prej shqiptimit ka kaluar shumë kohë e madje ka pasur përvetësime (në shekullin XX nga Martin Luther King e në shekullin XXI nga Barack Obama)- por thënia në origjinal dhe e nxjerrë prej një fjalie të zgjeruar cek thjesht se "Paqja nuk është mungesë e luftës", apo e shqipëruar më me rehati: "Mungesa e luftës nuk e bën paqen".

Pra, ashtu siç do ta përshkruante asokohe Spinoza, fakti që nuk ka luftë të armatosur në një vend a regjion nuk do të thotë se ai vend a regjion jeton në paqe. Dhe Ballkani Perëndimor mbase do të ishte shembulli më i mirë: vitin e ardhshëm mbushen tridhjetë vjet të Marrëveshjes së armëpushimit të Daytonit dhe 25 vjet të Rezolutës 1244, që iu dha fund luftës në Kosovë, por kjo periudhë jo domosdoshmërisht quhet jetë në paqe.

Paqja, në definicionin e vet të prekshtëm evropian, është gjendja e shoqërive të lira demokratike të cilat bashkëpunojnë mes vete - me katër liritë e lëvizjes së njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve - në një hapësirë të përbashkët sigurie. Natyrisht, është edhe kulturë paqeje e pajtimi, është edhe ballafaqim me të kaluarën, është edhe shumë gjëra të tjera.

Por, mbi të gjitha, paqja është gjendje aktive për dallim prej gjendjes pasive - të mungesës së luftës - të asaj që jetojmë në Ballkanin Perëndimor.

2.

Një intelektual liberal serb konstatoi në të njëjtën konferencë se në Ballka-



nin Perëndimor më nuk do të ketë luftë, dhe për të mbështetur këtë konstatim nxori, siç rëndom nxorën dhe në Athinë, argumentet me validitet se ekziston lodhja nga luftërat e shkatërrimet, se e tërë zona është me prani të NATO-s (tri shtete janë anëtare, Kosova e BH-ja janë nën mbrojtjen e NATO-s, e Serbia është tërësisht e rrethuar nga NATO-ja) dhe se synimet e të gjitha shteteve të regjionit janë integrimi në BE.

Argumentet mund të gjejnë oponencë po aq valide. Për shembull, se në ambientin e mungesës së paqes janë rritur gjeneratat e reja të cilat nuk e kanë përjetuar luftën, por kanë kaluar ditë pas dite në narracionin toksik të luftës për aq sa të jenë të cilësueshëm si ushtarë të luftërave të reja. Apo se prania e NATO-s nuk ka eliminuar, por, përkundrazi, ka nxitur një kundërshtim të organizuar të Rusisë në shtetet e Ballkanit Perëndimor që me luftë hibride të përpiqet të dëshmohe paaftësia e NATO-s për të mbajtur paqen në këtë regjion. Dhe, në fund, mund të vihet bukur në pyetje se i tërë regjioni dëshiron anëtarësim në BE: Kosova dhe Shqipëria në mënyrë konsistente tregojnë në anketa se ky është opsioni i vetëm i shoqërive të tyre, vendet si Serbia apo BH-ja janë thellësisht të ndara në afinitetet strategjike mes Perëndimit dhe Euroazisë.

3.

Por, edhe po të ishte krejtësisht ashtu - që Ballkani Perëndimor nuk do të

përfjetë luftë të armatosur - kjo nuk e heq konstatimin e Spinozës, që mungesa e luftimeve nuk do të thotë paqe. Dhe nuk u deshën as 48 orë nga konferenca në Athinë për të vërtetuar natyrën e pasigurisë dhe dimensionin e rrezikshmërisë që sjell jeta në mungesë paqeje. Në kanal in Ibër-Lepenc, i cili siguron një pjesë të madhe të ujit të pijshëm për një pjesë të madhe të Kosovës, si dhe furnizimin kritik të ujit për ftohjen e pajisjeve të gjenerimit të energjisë elektrike në termocentralet e Obiliqit, u vu një sasi e konsiderueshme e eksplozivit, i cili bëri demin që kishte dimensionin e një sulmi terrorist strategjik kundër Kosovës dhe përmbante njëkohësisht kërcënimin e madh potencial kundër vendit në rast se do të kishte në të ardhmen shpërthime të ngjashme me sasi më të madhe eksplozivi dhe përmasa më të mëdha shkatërrimi.

Shpërthimi në Zubin-Potok ishte në përmbajtje i ngjashëm me veprimet ushtarake të Rusisë kundër infrastrukturës kritike të Ukrainës - të pajisjeve të energjisë apo të furnizimit me ujë - porse në vend të luftës frontale apo bombardimit nga ajri me raketa e dronë, në këtë rast u përdor eksplozivi i vendosur nga persona të aftë për këtë.

Dhe, këtu ndahen dy rrugë vlerësimesh. Njëri që u hetua në një pjesë të reagimeve, madje të shteteve fqinje - pa hyrë në motivet që mund të kenë qenë të kundërta - e quajten këtë si "akt diversioni", duke e zhytur këtë akt në formë të nënvetëdijshme

në një operacion të rregullt gueril, paraushtarak apo ushtarak. Pra, diversionin e bëjnë njësitet diversante, të cilat operojnë tradicionalisht më thellë në prapavijë (duke prishur binarë treni, rrëzuar ura, e kështu me radhë). Por njësitet diversante këtë e bëjnë në luftë dhe e bëjnë rrjedhimisht të legjitimuara e të mbrojtura nga ligjet e luftës.

Zubin-Potoku nuk ishte zonë lufte dhe kushdo që ka vendosur eksplozivin nuk u përket njësiteve diversante, por një operacioni terrorist.

Këtu qëndron brenga plotësuese: shpërthimi i Zubin-Potokut është përshkallëzimi i parë terrorist i kësaj natyre (të sulmit kundër infrastrukturës kritike) që mund t'iu hapë rrugë aksioneve të tjera. Qeveritë që ia dhanë emrin "diversion" nuk e shohin mjaftueshëm potencialin shkatërrues që pati sulmi terrorist për të ardhmen. Gjegjësisht dhe ndonëse e gjykojnë veprimin, duke e vendosur në kategori "diversioni" e legjitimojnë si akt normal ushtarak.

Rruga e dytë vlerësuese është më e vështirë, madje më e vështirë edhe për t'u pranuar. E ajo është analogjia mes veprimeve të Rusisë në Ukrainë kundër infrastrukturës kritike (ndonëse me mjete luftarake) dhe aksionit terrorist në Zubin-Potok.

4.

Menjëherë pas shpërthimit filloi debati inicial i fajësisë, i cili u mbërthe


me akuzimin e palëve të supozuara që qëndrojnë prapa këtij aksioni. Nuk do mend se është me rëndësi të dihet se kush ka urdhëruar një operacion të këtillë.

Por mendoj se më tepër sesa akuza (për të cilën me gjasë ende nuk ka fakte të pakontestueshme) janë të qarta dy gjëra.

E para, sektori i sigurisë në Serbi ende gjendet me borxh ndaj pyetjes së mëhershme, asaj të sulmit paraushtarak në Banjskë, të udhëhequr nga Radoiçiqi. Pra, sa ka ditur sektori i sigurisë (përfshirë edhe shërbimet e zbulimit civile e ushtarake) për këtë aksion? Nëse ka ditur çka ka ndërmarrë, nëse nuk ka ditur a është e mundur që në Serbi të bëhen organizime paraushtarake dhe terroriste në kundërshtim me ligjet e vendit? Dhe, meqë Serbia ka premtuar nëpërmjet presidentit të vet që të bashkëpunojë edhe për rastin Banjska e Zubin-Potok, a mund të bëhen të ditura informatat për njohuritë dhe përkrahjen apo jo nga sektori i sigurisë i Serbisë për të dyja sulmet kundër Kosovës. Dhe dy, se çështja e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë është domosdoshmërisht edhe (apo parësisht) çështje e sigurisë, madje jo vetëm regjionale. Siç tha një zyrtar i lartë i Greqisë në konferencë, vendi i tij e kishte menduar gjithnjë Evropën si një zonë unike të sigurisë. Dhe, siç qe e natyrshme të jepej përgjigjja, zona unike e sigurisë evropiane duhet të nënkuptojë zonën unike të sigurisë të Ballkanit Perëndimor. koha

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI

NJË WEBSITE?

Beji vetes një dhuratë

MOS LEJONI QË VITI I RI 2025
TU GJEJË PA NJË WEBSITE

Dotech
website 



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT